

Arti i Luftës

nga

Sun Tzu

Përktheu në gjuhën angleze Thomas Cleary - 1991
Përktheu në gjuhën shqipe Driton Gani Nimani -Nëntorë 2011

drinimani@gmail.com

Përmbajtja

Parathënie nga përkthyesi T.Cleary
Hyrje nga përkthyesi T.Cleary.

- 1 Vlerësimet Strategjike
2. Zhvillimi i Betejës
3. Planifikimi i rrethimit
4. Formacionet
5. Forca
6. Zhbraztësia dhe plotënia
7. Lufta e armatosur
8. Adaptimet
9. Ushtritë manovruese
10. Terreni.
11. Nëntë pikat bazike
12. Sulmi i zjarrtë
13. Në përdorim të spiunëve

Parathënie nga përkthyesi T.Cleary

Arti i Luftës i përpiluar nga një luftëtarë dhe filozof kinez para më shumë se dy mijë vjetësh , akoma është libri më ndikues dhe prestigjioz i strategjisë në botë sot , është aq shumë i kërkuar dhe studiuar në Azi nga politikanët dhe zyrtarët ekzekutiv modern , pasi që ka qenë udhërrëfyes i strategjisë për liderët militarë dhe strategët në dy mileniumet e fundit dhe më shumë .

Në Japoni , shoqëri e cila është transformuar drejtpërdrejt nga kultura feudale në kulturë Korporative virtualisht për një natë ,njëkohësisht studentët e Artit të Luftës e kanë aplikuar këtë strategji të kësaj Klasike antike në politikat moderne dhe në bizneset me zellshmëri të njëjtë.

Në të vërtetë disa e shohin suksesin e rimëkëmbjes së Japonisë pas lufte si ilustrim të thënies klasike të Sun Tzus "Fitorja pa luftuar është më e mira".

Si studim i anatomisë së organizimit në konflikt , Arti i Luftës, në përgjithësi aplikohet në gara dhe konflikte , në çdo nivel që nga ndërpersonal deri në ndërkombëtarë. Qëllimi i tij është padukshmëria , fitorja pa betejë, një fuqi e pamundur të vritet nëpërmes kuptimit të fizikës , politikës dhe psikologjisë së konfliktit .

Ky përkthim i Artit të Luftës paraqet klasikën nga pikëvështrimi i sfondit të vet në traditën e madhe shpirtërore të Taoizmit.Qfarë është shumë karakteristike Taosite lidhur me Artin e Luftës është se i rekomandon vetëvetës në ditën e tashme moderne , është mënyra me të cilën fuqia në vazhdimësi kontrollohet nga ndjenja e madhe e humanizmit .Prandaj Arti i Luftës nuk është libër vetëm për luftë por edhe për paqe , para së gjithash për të kuptuar rrënjët dhe resolucionin e Konfliktit.

Hyrje nga përkthyesi T.Cleary.

Sipas një tregimi , Mbreti i Kinës antike e kishte pyetur fizikanin e tij , që ishte anëtarë i familjes së mjekëve , se cili nga ta ishte më i afti në artin e tyre. Fizikani, reputacioni i të cilit ishte i atillë sa që emri i tij u bë sinonim me shkencën mjekësore në Kinë , u përgjigj : " Vëllau im më i madhi , e shef shpirtin e sëmundjes dhe e cvendos atë para se të merrë formë , ashtu që emri i tij nuk del jashtë shtëpisë " .

"Vëllau i dytë e mjekon sëmundjen kur ka ngjarë është shfaqë qe një minutë, kështu që emri i tij nuk del jashtë lagjes "

"Kurse sa më përket mua , unë i punkturoj venat , përshkruaj recepte për ilaqe , dhe masazhoj lëkurën dhe kështu kohë pas kohe emri im del jashtë dhe ndëgjohet edhe nga mbretërit ."

Nga tregimet e Kinës së lashtë , asnjë nuk e përmbledh më mirë se ky tregim esencën e Arti i Luftës , që është e para nga shkrimet klasike të shkencës së strategjisë në konflikt. Artet mjekuese dhe Artet marciale mund të jenë botëra të ndara në përdorim të zakonshëm , por janë paralele në disa kuptime: në të kuptuarit , siq na thotë tregimi se me sa më pak investim të mënjanoen cenet apo evitohen humbjet më mirë është ;në kuptimin e asaj se që të dy artet përfshijnë strategji në përballjen me joharmoninë; dhe në kuptimin se tek të dyja artet dijenia e kuptimit të problemit është qelsi i zgjidhjes.

Sikurse në tregimin e mjekëve të lashtë , në filozofinë e Sun Tzus efekti më i lartë i diturisë dhe strategjisë është që konflikti të bëhet i panevojshëm. Dhe ashtu si tregimi i mjekëve , Sun Tzu shpjegon të gjitha shkallët e arteve marciale : mbikëqyrësi ushtarak parandalon komplotet e armikut; pastaj me radhë sipas rëndësisë vjen shkatërrimi i aleancës së armikut ; pastaj sulmi ndaj forcave të armatosura të tyre ; e ndërsa zgjidhja më e keqe është rrethimi i qytetit të tyre. Kjo strategji me të cilën mund të fitoni pa luftuar , bën përmbushjen e shumicës së objektivave duke bërë shumë pak veprime , e mban vulën karakteristike të Taoizmit , dituria tradicionale e lashtë që ka adoptuar që të dyja artet mjekuese dhe artet marciale në Kinë.Mjeshtërit e Taoizmit të lashtë kanë zbërthyer atë se si njeriu i dhunshëm dhe agresiv që shfaqet i pamëshirshëm e që në të vërtetë është shumë emocional; pastaj ata e vrasin emocionalen me jomëshirën e tyre para se ta zbulojnë haptazi natyrën spontane të humanitetit të lirë .

Pamëshira e vërtetë , ftohtësia e objektivitetit të tërsishëm , gjithmonë përfshinë vetvetën në vetë cungimin e vlerësimit të situatës reale.Kjo është tirania e Lao Tzus në kur thotë në *Tao-te Ching* se Universi është johuman dhe urtësia i shef njerëzit në cilësinë e qenit të munduar që përdoret për sakrificë.Chuang Tzu, një mjeshtër tjetër i lashtë i Taoizmit , gjithashtu jep një numër dramatik të ilustrimeve të tiranisë ndaj vetvetës si një ushtrim në perspektivë i dizajnuar për të udhëheë në pushimin e konfliktit të brendshëm dhe të jashtëm .

Ky " johumanitet " nuk përdoret nga filozofët origjinal si arsyetim për agresionin

posesiv kuazi-tiran , por si meditim ne përfundim i paarsyeshmërisë së lakmisë dhe posesivitetit që nënkuptojnë agresionin.

Në Indi , aspiruesit Budist kanë vizituar tokat që digjeshin dhe shikonin djegjen e trupave të atyre që familja e tyre nuk ka pasur mundësi që të kryejnë një krematorium të rregullt fetar.Këtë vizitë budistët e bënë që të tmerronin lakminë dhe posesivitetin e tyre tuj shpresu se i largonin nga vetja e tyre.Pas kësaj ata e kthenin mendjen e vetë drejt mendimeve ideale individuale dhe shoqërive ideale. Ngjajshëm , Mjeshtri Sun i zhytë lexuesit e tij në luftratë shkatruese , nga faza inicuese të ndëshkimit dhe tëhuajësimin deri në format më ekstreme të sulmit ndezës dhe rrethimit , i parë si lloj i kanibalizmit masiv i burimeve njerzore dhe natyrore.Me këtë pajisje ai i jep lexuesit një ndjenjë të rritur për thjeshtësinë e virtyteve individuale she sociale të ekspozuara nga pacifistët humanitarë.

Paradoksi shpesh mendohet se është pajisje standarde e psikologjisë Taoiste, që përdoret për të tejkalimin e barrierave të paperceptueshme të vetëdijes.Me gjasë paradoksi i Arti i Luftës është në opozitë ndaj luftës .Dhe meqë Arti i Luftës lufton kundër luftës , këtë e manifeston nëpërmjet parimeve të veta; depërton në vijat e armikut , zbulon sekretet e armikut , dhe ndrron zemrat e trupave të armikut .

Komentimi në këtë përkthim është përzgjedhur nga koleksionet standarde të njëmbëdhjetë përkthyesve që kanë jetuar nga shekulli i dytë deri në të dymbëdhjetin para erës sonë.

1

Vlerësimet Strategjike

Aksioni Ushtarak është i rëndësishëm për kombin - është bazë e jetës dhe vdekjes ,shteg i mbijetesës dhe shkatërrimit ,prandaj është qështje urgjente që të ekzaminohet ai.

Bazë e ka kuptimin e lokacionit , vendi i zgjedhur për betejë - fitoje përparësinë dhe jeton , humbe përparësinë dhe do vdesësh .Prandaj aksioni ushtarak quhet bazë e vdekjes dhe jetës . Shtegu ka kuptimin e rrugës që i përshatet situatës dhe themelimin e fitores - gjeje këtë dhe do të mbijetosh, e humbe këtë do të shkatërrohesh.

Prandaj mati pesë gjëra , përdori këto vëlerësime që të bësh krahasimet , dhe kështu gjeje se cilat janë kushtet. Këto pesë gjëra janë rruga, koha, terreni, lidershipi dhe disciplina.

Këto gjëra duhet të vëlerësohen në Shtabin kryesor-- së pari vlerësoje palën tënde dhe palën kundërshtarë në aspektin e këtyre pesë gjërave, duke përcaktuar se kush është më i fuqishëm.Pastaj mund ta përcaktosh se cili ka më shumë gjasa të triumfoj.

Rruga ka kuptimin e nxitjes së njerëzve që të kenë të njëjtin qëllim si lidershipi , në mënyrë që ata të ndajnë së bashku edhe jetën edhe vdekjen , duke mos pasur frikë nga rreziku .

Rruga nënkupton humanitetin dhe drejtësinë .Në kohërat e lashta një ministër i famshëm i shtetit e ka pyetur filozofin politik lidhur me qështjet ushtarake .Filozofi është përgjegjur , " Humaniteti dhe Drejtësia janë gjërat me të cilat qeveriset drejtë . Kur qeverisja kryhet në mënyrë të rregullt , njerëzit ndjehen të afërt me lidershipin dhe pak mendojnë nëse duhet dhënë jetën për ta ."

Koha e ka kuptimin e Sezonës .

Në kohërat e lashta shumë ushtarë kan humbur gishtrinjet e këmbëve nga tejngrirja (që ka rezultu me prishje të mishit) në kampanjat ushtarake të drejtuara kundër Hunëve , e ndërsa shumë ushtarë kan vdekur si rezultat i mortajës që i ka rënë ushtrisë në kampanjën kundër fiseve jugore. Kjo ka ndodhë për shkak se aksionet janë zhvilluar në dimër dhe verë .

**Terreni duhet të vlerohet sa i përket qështjes së distancës ,
vështirësitë apo lëhtësitë e udhëtimit , dimensionet dhe siguria.**

Në cilindo operacion ushatrak së pari është e rëndësishme që të dihet shtrirja e tokës. Kur e dini distancën që do ta udhëtoni , atëherë mund të planifikoni se a të vazhdoni drejtpërdrejt apo nëpërmjet rrugëve qarkore. Kur e dini vështirësin apo lehtësinë e udhëtimit atëherë mund të përcaktoni përparësitë e këmbësorisë apo trupave kalorsiak. Kur të dini dimensionet e arenës atëherë mund të vëlerësoni sa trupa ju nevojiten , shumë apo pak . Kur e dini sigurinë relative të terrenit mund të vendosni se a do bëni betejë apo shpërndarje.

**Lidershipi është qështje e intelegjencës , besueshmërisë,
humanitetit, guximit dhe rreptësisë.**

Rruga e Mbretërve të lashtë ka qenë që humaniteti të konsiderohet më i famëshmi, derisa artistët marcial e kanë konsideruar intelegjencën më të famshmen. Kjo është kështu sepse intelegjenca përfshinë aftësinë për të planifikuar dhe të dihet se kur të ndërroj efektivisht . Besueshmëria nënkupton që të bëhen njerëzit të vetëdijshëm për shpërblimin apo dënimin. Humaniteti nënkupton dashurinë dhe ndjenjë ndaj njerëzve, duke qenë i vetëdijshëm për përkushtimin e pahile të tyre. Guxim nënkupton që të kapen fortë mundësitë për tu bërë fitorja e sigurtë, dhe e paluhatshme. Rreptësia nënkupton që të themelohet disciplina në rangjet nga dënimet strikte.

**Disciplina nënkupton organizimin ,
zingjirin komandues, dhe logjistikën.**

Organizata e ka kuptimin se trupat duhet të grupohen në mënyrë të rregullt. Zingjiri komandues e ka kuptimin se aty duhet të ketë oficer që duhet ti mbaj trupat së bashku dhe ti udhëheqë ata . Logjistika e ka kuptimin e mbikqyrjes së furnizimeve.

**Cdo gjeneral ka ndëgjuar për këto pesë gjëra
Ata që i i dijnë këto triumfojnë , ata që nuk i dijnë
këto nuk triumfojnë.**

**Prandaj përdori këto vlerësime për krahasime ,që
të gjinden se cfarë janë kushtet. Që të mund të
gjejmë se, cili lidership politik e ka rrugën?
Cili gjeneral e ka rrugën ? Kush ka terren dhe
klime më të mirë ? Disciplina e cilit është më efektive?
Trupat e kujt janë më të fortë ? Oficer dhe
ushtarakë e cilës palë janë të trajnuar më mirë?
Sistemi i cilit i shpërblimit dhe dënimeve është
më i pastër? Kështu do të dini se kush do të fitojë .**

Dokumentet Klasike Antike thonë "Ai i cili më trajton mirë është Lideri im, ai i cili më trajton vrazhdët është armiku im". Pyetja është , cila palë ka qeveri humane dhe cila palë ka qeveri mizore.

**Vëlerësoji përparësitë në marrjen e këshillave ,
pastaj strukturoji forcat e tua në mënyrë adekuate,
për të shtuar taktikat e jashtëzakonshme. Forcat duhet të
strukturohen në mënyrë strategjike, duke u bazuar në atë
se çfarë është me përparësi.**

**Operacioni ushtarak përfshinë mashtrimin. Megjithëse
je kompetent, lë përshtypje se je jokompetent.
Sado që je efektiv , lë përshtypje se je joefektiv.**

Kjo e ka kuptimin se atëherë kur je vërtetë kompetent dhe efektiv, për së jashtmi lë përshtypje të dukesh jokompetent dhe joefektiv, ashtu që të shkaktosh armikut që të jetë i papregaditur.

Mashtrimi është për qëllim të kërkimit të fitores përmbi një armik; që të komandohet një grup kërkohet besueshmëria.

**Kur e ke ndërmend që të sulmosh së shpejti,
bëje që të duket se do të marrësh kohë të gjatë
deri sa të sulmosh; kur e ke ndërmend që të sulmosh më vonë
bëj që të duket se shumë shpejt do të sulmosh.**

**Vendos për to sipas prospektit të përfitimit, dhe ndërmerr
ato kur je në konfuzion.**

Kur ishin në luftë ndërmjet vete shtetet eua dhe Yue, eua i dërgoi tre mijë kriminelë që të jipet një pamje e

joorganizimit në mënyrë që Yue të joshen. Disa nga kriminelët ikën , disa u dorëzuan ; Armara e Yue luftoj e ngazllyer sepse mendonin se kishin të bëjnë me armatë të paorganizuar dhe kështu pastaj humbën rrastë nga armata e disiplinuar e eua.

**Kur janë të plotësuar të jesh gati kundrejt tyre
kur janë të fortë , shmang'ju atyre .**

Nëse qeveria e Armikut është e plotësuar - që e ka kuptimin se aty ka dashuri të dyanshme në mes të sunduesit dhe të sunduarit , se ka qartësi dhe besueshmëri në sistemin e dënimit dhe shpërbllimit - dhe ushtarët janë mirë të trajnuar - atëherë duhet të hapni të jeni vigjilent të hapni sytë katër dhe të ruheni nga ta. Mos pritni për përplasje që të bëni përgaditjet tuaja .

Përdor urrejtjen që ata të bien në qorganizim.

Kur Lideri Ushtarak i tyre është **Obstreperous** , duhet të irritoni ata që ti bëni ata

nervoz - pastaj do të bëhen të shkujdesur dhe do të injorojnë strategjinë e tyre origjinale.

**Përdore përuiljen që ti bësh ata të ndihen krenarë.
Lodhi ata me ikje.Shkakto përçarje në mes tyre.sulmoji ata
kur janë të papregaditur, bëre lëvizjen tënde kur
nuk e presin atë.**

Sulmo në shpraztësitë e tyre , atakoi kur janë të relaksuar , mos lejo që armiku të mendoj se si të përgaditet .Kjo është se pse është thënë se në operacionet ushtarake patrajtshmëria është më e efektshme.Një nga luftëtarët lider më të mëdhenj ka thënë ,"Një nga lëvizjet më frytëdhënëse është ajo e cila është e papritshme ; plani më i mirë është ai i cili është i paditur ".

**Formacioni dhe procedura e përdorur nga ushtria
nuk duhet të përhapet paraprakisht.**

Përhapja e ka kuptimin e rrjedhjes së informatës.Ushtria nuk ka formë konstante , ashtu siq uji nuk ka formë konstante - adaptoju rrethanave kur ballafaqohesh me armikun, duke mos i lënë atyre që paraprakisht të dijnë se qfarë do të bësh . Prandaj , vlerësimi i armikut është në mendje , observimi i situatës është në sytë.

**Ai i cili e ka paramenduar fitoren në shtabin qendror
madje para se të bëhet beteja është ai i cili ka më
së shumti faktorë strategjik në anën e tij. Ai i cili paramendon
paaftësinë për të triumfu në shtabin qendror para se të
filloj beteja është ai i cili ka më pak faktorë strategjik në anën e tij.
Ai i cili ka shumë faktorë strategjik në anën e tij fiton,
ai i cili ka disa faktorë strategjik në anën e tij humb -
sa më shumë aq më mirë e sa për atë që nuk
ka faktorë strategjik në anën e tij mjer për të .
Observimi i qështjes në këtë mënyrë , mund të
shoh se kush do të fiton dhe kush do të humb .**

Kur strategjia juaj është e thellë dhe e largët , atëherë cfarë arrini ju me kalkulimet tuaja është shumë , pra ju mund të fitoni madje para se të luftoni.Kur mendimi juaj strategjik është i cekët dhe i ngushtë , atëherë cfarë arrini sipas kalkulimeve tuaja është e pakët , kështu që ju humbni para se të bëni betejën.Prandaj është thënë se luftëtarët fitimtarë së pari fitojnë pastaj shkojnë në luftë, derisa luftëtarët e mundur së pari shkojnë në luftë pastaj e kërkojnë fitoren.

2

Zhvillimi i Betejës

Kur zhvilloni betejën , edhe nëse jeni duke fituar , nëse vazhdoni për një kohë të gjatë ,kjo do të bëjë që të bëhen të ngathta forcat dhe do të topitet durimi juaj; Nëse e rrethoni një kshtjellë , fuqia juaj do të shpenzohet. Nëse i mbani armatat e juaja për një kohë të gjatë në terren , furnizimet e juaja do të jenë të pamjaftueshme për ju .

Armët janë mjete të ogurit të zi - nëse vihen në veprim për një kohë të tejzgjatur do të sjellin fatëkeqësi . Ashtu siq është thënë , " Ata që dëshirojnë të luftojnë deri në topitje dhe vazhdojnë , ushtria e tyre shkon drejt humnerës."

Kur forcat e juaja janë amortizuar, durimi juaj është topitur , fuqia juaj është shpenzuar , dhe furnizimet e juaja kanë mbaruar, atëherë të tjerët mund të marrin përparsinë kundrejt debilitetit tuaj dhe do të ngriten .Pastaj edhe nëse ke këshilltarë të menqur ti nuk mund të kthesh gjërat mbrapsht në të mirë në fund.

Prandaj kam ndëgjuar për operacione ushtarake të cilat kanë qenë të plogëta por me kohë , por nuk kam parë kurrë që lufta e tillë të ketë qenë e shkathët dhe që ka zgjatë kohë të gjatë. Kurrë nuk është e dobishme për kombin që të ketë operacion ushtarak që vazhdon për një kohë të gjatë.

Siq është thënë , bëhu i shpejt kur murmurima lëshon tingullin para teje , shfrytëzo rastin që ti mbyllësh veshët , aq shpejt sa vetëtima që ndriqon më shpejt se sa ti mund të mbyllësh sytë.

Prandaj ata që nuk janë tërësisht të vetëdijsëm për të metat në përdorimin e armëve nuk mund të jenq tërësisht të vetëdijsëm për përparësitë në përdorimin e armëve.

Ata që e përdorinë ushtrinë në mënyrë të shkathët dhe të menqur nuk i ngritin trupat dy herë , dhe nuk i japin tri racione ushqim.

Kjo ka kuptimin e asaj se kur i mobilizon njerëzit në shërbim njëherë dhe menjëherë e rrëmben fitoren - nuk shkon mbrapa në shtetin tëndë që të ngritësh më shumë trupa .Së pari e i furnizon me ushqim ushtrinë tënde pastaj ushqehesh nga ushqimet e armikut tëndë.

Me marrjen e pajisjeve nga vendi juaj por duke u furnizuar me ushqime nga vendi armik do të keni që të dyja të mjaftueshme si armët ashtu edhe ushqimet .

Kur shteti varfërohet nga operacionet ushtarake , është për shkak të transportit të furnizimeve në vend të largët. Transportimi i pajisjeve në vendin e largët , dhe popullata do të varfërohet.

Ata që janë afër armatës shesin me qmim të lartë .Për shkak të qmimeve të larta , pasuria e njerzve të rëndomtë topitet.

Kur furnizimet transportohen nga larg , njerëzit janë të rraskapitur nga shpenzimet. në tregjet që janë afër armatës, qmimet e ushqimeve fluturojnë përpjetë.Për atë kampanjate gjata ushtarake janë epidemi për kombin.

Kur burimet të harxhohen , atëherë mbledhja e taksave bëhet nën presion.

Kur fuqia dhe burimet harxhohen, atëherë atëdheu dobësohet . Njerëzit e rëndomtë janë të privuar nga 70% e buxhetit , derisa harxhimet e qeverisë për pajisje vlerësohen deri 60% e atij buxheti.

Njerëzit janë themeli i shtetit , ushqimi është parajsa e njerëzve . Ata që sundojnë tjerët duhet të respektojnë këtë dhe të kursejnë .

Prandaj gjenerali i menqur përpiket shumë që të merr ushqimin nga vendi armik.Cdo funtë në kundërvlerë të ushqimit i marrë nga vendi i armikut është i barasvlefshëm me 20 funta në kundërvlerë të të njëjtës sasi të ushqimit që e keni marrë me vete nga vendi juaj i origjinës.

Provisioni i një funtë kundërvlerë të ushqimit është 20 funta provision për ta bartur tek ushtria në distanca të largëta.

Pra cka e mbytë armikun është urrejtja , cfarë i rrëmben të mirat e armikut është shpërblimi .

Nëse i shpërbleni njerëzit tuaj me lavdrime , ajo do ti bëjë ata që të luftojnë me iniciativen e vet, ashtu që të mirat e armikut do të mirren .Për këtë është thënë se ku ka shpërblime të mëdha aty ka njerëz të guximshëm.

Prandaj në betejat me kaqorre, shpërbleje të parin

që uzurpon së paku 10 kaqorre.

Nëse ju e shpërbleni gjithsecilin , nuk do të ketë mjaftueshëm për të gjithë , prandaj e jep shpërblimin për një në mënyrë që të inkurajohen të gjithë .

**Ndërroji ngjyrat e tyre , përdori ato të tyre të përziera me tuajat .
Trajtoji ushtarët mirë , kudesu mirë për ta .**

Ushtarët e kapur duhet të trajtohen mirë , që ti bësh ata të punojnë për ty .

**Kjo quhet tejkalimi i kundërshtarit dhe
rritje e fuqisë tënde në këmbë .**

Nëse e përdorë armikun që ta mposhtësh armikun , do të jesh i fortë kudo që të shkosh .

**Pra gjë e rëndësishme , në operacionet ushtarake
është fitorja , e jo këmbëngulja .**

Këmbëngulja nuk është e dobishme . Një armatë është sikur zjarri- nëse nuk e nxjerr jashtë do ta djegë veten .

**Kështu , ne e dijmë se lider i një armate është përgjegjës
për jetërat e njerëzve dhe sigurinë e kombit .**

3

Planifikimi i rrethimit

Rregulla e përgjithshme për përdorimin e ushtrisë është ajo se më mirë është të mbahet kombi i paprekur se sa të shkatërrohet. Më mirë të mbahet një armatë e paprekur se sa të shkatërrohet , më mirë të mbahet divizioni i paprekur se sa të shkatërrohet , më mirë të mbahet batalioni i paprekur se sa të shkatërrohet , më mirë të mbahet njësi e paprekur se sa të shkatërrohet .

ëei Liaozi ka thënë , " Praktikimi i arteve marciale , vlerësoji kundërshtarët tuaj , shkakto që të humbasin shpirtin dhe drejtimin ashtu që edhe nëse armata kundërshtarë është e paprekur kot e kanë është e padobishme - kjo është fitore sipas Taos. Nëse e shkatërron armatën që ka presantuar dhe i mbytë gjeneralët , gjuan rafale pa pra , mbledh turmë dhe usurpon tokë , kjo është fitore me forcë."

Prandaj ata që fitojnë cdo betejë në të vërtetë nuk janë të shkathët - ata që shkaktojnë ndasi në armatat e tjerëve dhe bëhen të padobishme pa luftë është më e mira nga të gjitha .

Ushtaraku i suksesshëm sulmon derisa planet shtrohen . Pas kësaj me radhë më e mira është atakimi i aleancave të armikut . E fundit vjen si zgjidhje atakimi i armatës armike.

Të qenurit i mirë në sulmin e suksesshëm , zbarkimi i forcave pa asnjë dëmtim, është edhe një arritje tjetër. Prandaj një sundimtar i madh luftarak ka thënë , " Ai i cili lufton për fitore përpara shpatave të zhveshura nuk është gjeneral i mirë" .

Më e ulta është atakimi i qyteteve . Rrethimi i qytetit bëhet vetëm si zgjedhje e fundit e pashmangshme .

Merrë kohë tre muaj për të bërë gadi makinerinë tuaj dhe tre muaj për të kompletu inzhinjerinë e rrethimit.

Disa thonë se qëllimi i Mjeshtrit Sun këtu është ajo se nuk duhet të bëheni nervoz dhe të shpejtoni me sulm. Kjo është arsyeja pse ai thotë të merrni kohë .

Nëse gjenerali nuk mund ta tejkaloj hidhërimin e tij dhe e ka vendsur armatën e tij të madhe përreth kështjellës , , vriten një e treta e ushtrisë së tij, edhe pas gjithë kësaj kështjella nuk është marrë , ky është sulm katastrofik.

Prandaj ai i cili është i mirë në artet marciale i mund forcat

**tjera pa betejë, i pushton qytetet e tjerëve pa rrethim ,
i shkatrron kombet e tjerëve për një kohë të shkurtë .**

Artisti i aftë i arteve marciale i rrënon planet , i përquanë marrëdhëniet e aleancës së armikut , ua ndërpret furnizimet , apo bllokon rrugën dhe kështu mund ti mund njerëzit pa i luftuar .

është urgjente që të urdhërohen të gjitha fraksionet për fitore të plotë , ashtu që armata mos ta ndahet në garnizone dhe përfitimi do të jetë më i madh .Ky është ligji i rrethimit strategjik.

Fitore complete është kur armata nuk lufton, qyteti nuk rrethohet , shkatërrimi nuk fillon dhe të vazhdojë, por në secilin rast armiku mundet me strategji.

Prandaj rregulla e përdorimit të ushtrisë është ajo se nëse e vlerëson kundërshtarin 10 me një , atëherë rrethoni ata ; pesë me një , sulmo ; dy me një , ndaji .

**Nëse jeni të barabartë , atëherë luftoni nëse keni mundësi .
Nëse jeni disa, atëherë qëndroni larg konfrontimit nëse mundeni.
Nëse nuk jeni aq të mirë , atëherë ikni nëse keni mundësi .**

Kjo këshillë aplikohet në rastin kur cdo gjë tjetër është e barabartë .Nëse forcat tuaja janë të rregullta derisa të atyre janë në kaos , nëse ju jeni të ekzaltuar dhe ata janë të demoralizuar , atëherë edhe nëse janë më shumë në numër mund të bëni betejën .Nëse ushtarët tuaj , forca , strategjia , dhe guximi janë më të vogël se sa e kundërshtarit , atëherë duhet të tërhiqeni dhe të shikoni për ndonjë hyrje .

**Prandaj nëse pjesa e vogël është kokëfortë ,
bëhet i burgosur i anës më të madhe .**

Kjo e ka kuptimin e asaj se nëse një vend i vogël nuk i vlerëson forcat e veta dhe guxon të bëhet armik i një vendi më të madh , pa marrë parasysh se çfarë mbrojtje të mirë që bënë , kjo është me ftesë të vetën bëhet komb i burgosur. "Analet e pranverës dhe vjeshtës " thotë , " Nëse nuk mund të bëhesh i fortë , por nuk je as i dobët , kjo do të rezultoj në mposhtjen tuaj ".

Gjeneralët janë asistentët e kombit . Kur asistimi i tyre është i plotë , vendi është i fortë . Kur asistenca e tyre është defektive, vendi është i dobët .

Nëse gjeneralët nuk i ndihmojnë lidërsipit , dhe kanë ndjenja të dyfishta në zemër ,atëherë vendi do të jetë i dobët .Prandaj është e rëndësishme që të jeni të kujdesshëm në zgjedhjen e njerëzve për pozita dhe përgjegjësi .

Pra janë tri mënyra në të cilat lidreshipi civil shkakton probleme ushtarake .Kur Lidreshipi civil është i pavetëdijshëm për faktet , i thotë ushtrisë të avancoj atëherë kur nuk duhet , apo i thotë ushtrisë të tërhiqen kur nuk duhet , kjo quhet prangosje e ushtrisë . Rasti tjetër kur Lidreshipi civil është injorant lidhur me qështjet ushtarake por ka përgjegjësi të njëjtë me ushtarakët në qeverisjen e armatës, ushtarët bien në konfuzion. Kur Lidreshipi civil është injorant për manovrat ushtarake por ka përgjegjësi të njëjtë me ushtarakët në komandimin e armatës , ushtarët hezitojnë. Nëse armata bëhet konfuzë dhe hezituese , problemet vijnë nga kundërshtarët. Kjo quhet shmangje e fitores duke qrrregulluar ushtrinë.

Nëse tenton të përdorësh metodat e qeverisë civile që të qeverisësh operacione ushtarake, operacioni do të jetë konfuz.

**Pra janë pesë mënyra që të dihet se kush do të fitojë .
Ata që e dinë se kur duhet të luftojnë e kur nuk duhet të luftojnë janë fitimtarë.
Ata që e dallojnë kur duhet të përdorin shumë trupa apo pak janë fitimtarë .
Ata ushtria e të cilëve si me rang më të lartë ashtu edhe ata me rang më të ulët kanë dëshirën e e njëjtë të zjarrtë për fitore janë fitimtarë .
Ata të cilët ballafaqohen me të papritura ,e që janë të pregaditur për këso befasi janë fitimtarë .
Ajo armatë gjeneralët e së cilës janë të aftë dhe nuk sforcohen nga qeveria e tyre janë fitimtarë.
Këto janë pesë parametra për të ditur se kush do të fitojë.**

Të diskutosh lidhur me urdhërat e qeverisë për të gjitha këto është sikurse të shpallësh udhëheqësve tu se dëshiron ta ndalësh zjarrin - dhe kur të kthehesh me një urdhër të ri , nuk ka mbetur asgjë veq hirit.

Pra është thënë nëse i njuh tjerët dhe e njuh vehten , nuk do të rrezikohesh në njëqind beteja ; nëse nuk i njuh tjerët por e njuh veten , një e fiton një e humbë; nëse nuk e njuh veten dhe nuk i njuh tjerët , do të rrezikohesh në secilën betejë .

4

Formacionet

Në kohët e lashta luftëtarët e shkathët , së pari e bënin vetën të padukshëm, dhe pastaj shikonin për dobësitë e kundërshtarit të tyre.

Bërja e vetëvetës të padukshëm e ka kuptimin e njohjes së vetëvetës; pritja për të zbulu dobësinë e kundërshtarit e ka kuptimin e njohjes së tjerëve .

Padukshmëria shtë në vetvete , dobësia është në kundërshtarin .

Prandaj luftëtarët e shkathët kanë mundësi të bëhen të padukshëm , por nuk mund të shkaktojnë që kundërshtari i tyre të bëhet i dobët .

Nëse kundërshtarët nuk kanë formacion që ta gjejnë, asnjë shpraztësi pakujdesi që nëpërmes saj të përparojë , si mund ta mundësh atë edhe nëse jeni mirë i pajisur ?

Për atë është thënë se fitorja mund të dallohet por jo të prodhohet . Padukshmëria është qështje e mbrojtjes, dhe dobësia është qështje e sulmit.

Përderisa nuk ke parë formacione të dobëta tek kundërshtari , fshihe formën tënde , duke e përgaditur vetvetën tënde në atë mënyrë që të bëhesh si i padukshëm , në mënyrë që të ruash vetvetën.Kur kundërshtari ka formacione të dobëta, atëherë është koha për ti sulmuar ata .

Mbrojta është për kohën e pamjaftueshmërisë , ndërsa sulmi është për kohërat e tepricës .

Ata të aftit në mbrojtje ,fshihen në thellësitë më të thella të tokës , ata të shkathëtit në sulm manovrojnë në në lartësi më të larta të qiellit.Prandaj ata mund të mbrojnë vetëvetën dhe të arrijnë fitore të tërësishme.

Në mbrojtje , ju heshtni , i mbuloni gjurmët tuaja, i fshihni sikurse fantazma shpirtat përfundi dhe tokën, e bëni të padukshme për gjithsecilin .

Në sulm , lëvizja juaj është e pavonuar dhe bërtitni fuqishëm , shpejt ashtu si murmurima dhe vetëttima , ashtu si vjen nga qielli , duke qenë i papërgaditur për tu mbrojtur nga ai .

**Arritja e fitores kur e dinë të gjithë nuk është vërtetët e shkathët .
Të gjithë e quajnë të mirë fitoren në betejë , por në të vërtetë nuk është vërtetë e mirë .**

Gjithsecili thotë se fitorja në betejë është e mirë, por nëse dinakëri të hollë dhe vërenë të fshehtën me anën e së cilës e rrëmben fitoren atëherë kur nuk ka formë , kjo vërtetë është e mirë.

**Nuk merr shumë forcë të madhe që të ngriten flokët ,
nuk ka nevojë për sy të mprehtë që të shihet dielli dhe hëna ,
nuk ka nevojë për vesh të mprehtë për të ndëgju murmurimën.**

Cfarë dinë të gjithë nuk quhet dituri , fitorja ndaj tjerëve me betejë forcash nuk konsiderohet e mirë.

Në kohërat e lashta ata që njiheshin si luftëtarë të mirë triumfonin , kur ishte lehtë të triumfonin.

Nëse jeni në gjendje të siguronit fitoren pasi ta keni futur kundërshtarin në konflikt të armatosur, ajo fitre është e vështirë .Nëse shihni dobësinë dhe vëreni të fshehtën , nëpërmes së cilës e thyeni kundërshtarin para se të marrë formë , kjo është fitore e lehtë .

Prandaj fitoret e luftëtarëve të mirë nuk dallohen për menquri dhe guximshmëri.Prandaj fitoret e tyre në beteja nuk janë të rastësishme apo fat.Fitoret e tyre nuk janë fat përshkak se ata e pozicionojnë vetëvetën aty ku sigurtë do të fitojnë, duke triumfuar përmbi ata të cilët tashmë kanë humbur .

Dituria e madhe nuk është e dukshme , merita e madhe nuk reklamohet. Kur shihni dobësi , është lehtë për të fituar - cfarë ka të bëjë me guxim dhe menquri? Kur zgjidhet problemi para se të marrë formë , kush e quan atë menquri ?Kur ka fitore pa betejë , kush fletë për guximin ?

Pra Luftëtarët e mirë marrin qëndrim dhe qëndrojnë aty ku nuk mund të humbin , dhe nuk dështojnë të vërejnë kushtet që e bëjnë një kundërshatrë që të prijë në disfatë.

**Prandaj armata fitimtare së pari fiton pastaj kërkon beteja ;
armata e mundur së pari bënë betejën pastaj kërkon fitoren.**

Kjo është ndryshimi në mes të atyre me strategji dhe atyre pa parashikim.

Ata që përdorin armët mirë kultivojnë rrugën dhe i përmbahen rregullave. Në këtë mënyrë ata mund të qeverisin në atë mënyrë për të triumfuar përmbi të prishtit .

Përdorimi i harmonisë për të gjuajtur poshtë opozitën , duke mos e atakuar një vend të pafajshëm , mosmarrja e të burgosurve apo plaqkës kudo që shkn armata, mosshkatërrimi i maleve apo mos ndotja e puseve , flliqjen e vendve të shenjta të atij vendi në qytete dhe fshatrat në të cilat kalon , mos përsëritjen e gabimeve të cilat i ka bërë kombi që po jep shpirt- krejt kjo quhet Rruga dhe rregullat e saj . Kur armata është e disiplinuar në mënyrë strikte, deri në atë pikë ku ushtarët më parë do kishin vdekur se sa të mos binden , shpërblimet dhe dënimet që janë të besueshme dhe veq sa janë themeluar - kur lidershipi ushtarak është i atillë që mund ta arrijë këtë , mund ta triumfojë përmbi qeverinë civile të korruptuar të kundërshtarit .

Rregullat e ushtrisë janë pesë: matjet, vlerësimet, kalkulimet, krahasimet , dhe fitorja. Arsyeja i ngritin matjet, matjet i ngritin vlerësimet , vlerësimet i ngritin kalkulimet , kalkulimet ngritin krahasimet , krahasimet ngritin fitoren.

Me krahasimin e matjeve ju e dini se ku rrjedhë fitorja dhe humbja .

Prandaj armata fitimtare është sikur se pound i krahasuar me gram , armata e mundur është sikurse grami i krahasuar me pound .

Kur fitimtarët ngritin jerëzit e vetë për të shkuar në betejë sikurse do e kishin drejtuar një ujë me përmasa të mëdha në një grykë të thellë , kjo është qështje e marrjes formë .

Kur uji akumulohet në një grykë të thellë , askush nuk mund ta masë atë sasi , mu ashtu sikurse mbrojtja jonë nuk jep formë . Kur uji lirohet dhe bije poshtë rrëke , mu ashtu sikur sulmi ynë që është i parezistueshëm.

5

Forca

Forca e ka kuptimin e lëvizjes së energjisë së akumuluar ose inercionit. Luftëtarët e aftë janë në gjendje që të lejojnë forcën e inercionit që të grabitet fitorja pa e vënë në funksion krejt fuqinë e tyre .

Qeverisja e një numri të madh megjithëse qeverisja e numrit më të vogël është qështje e ndarjes në grupe. Në betejë më një numër të madh megjithëse beteja me një numër më të vogël është qështje e formës dhe thirrjeve.

Format dhe thirrjet i referohen formacioneve dhe shenjimeve që përdoren për të rregulluar trupat dhe të koordinohen lëvizjet .

Bërja e armatave të afta që të mirret ajo e kundërshtarit duke mos qenë i dështuar është qështje e mënyrave joortodokse dhe ortodokse.

Mënyrat Ortodokse dhe jo Ortodokse nuk janë të fiksuara , por janë sikur një gjiro. Perandori Taizong i dinastisë Tang , luftëtarë dhe administrator i famshëm , ka folur për manipulimin e perceptimeve të kundërshtarit e asaj se qka është ortodokse dhe qka është jortodokse , pastaj ka sulmuar papritmas , duke kombinuar që të dyja në një , duke u bërë e pakuptueshme për kundërshtarët.

Që të ngjeshen forcat e armatosura të bëhen si gurë të hedhur në ve është qështje e shpaztësisë dhe plotënisë.

Kur i nxitni kundërshtarët tuaj që të vijnë tek ti , atëherë forca e tyre është gjithnjë e shprazët , përderisa nuk shkoni tek ata , forca juaja është gjithnjë e plotë .Sulmimi i shpaztësisë me plotëni është sikurse hedhja e gurëve në ve - vetë sigurisht do të thyhen .

Në betejë , konfrontimi bëhet , drejtpërdrejt , fitorja arrihet me befasi .

Prandaj ata të shkathtit në metoda joortodokse janë pambarim sikurse qielli dhe toka , të pashterrshëm sikurse . Kur vijnë në fund , ata fillojnë përsëri, sikurse ditët dhe muajt ; ata vdesin dhe rilindin , sikurse katër sezonat .

Dielli dhe hëna udhëtojnë përmes qiellit , ata përendojnë dhe lindin përsëri .Katër sezonat e mbizotrojnë njëra tjetrën , duke shkëlqyer dhe pastaj treten.Kjo është metaforë e ndrrimit të befasishëm të lëvizjeve joortodokse dhe konfrontimeve të drejtpërdrejta ortodokse , duke u përzier së bashku në një tërësi , duke mbaruar dhe filluar në vazhdimësi .

Janë vetëm pesë nota në pentagramin muzikor , por variacionet e tyre janë aq shumë sa që nuk mund të ndëgjohen të gjitha . Janë vetëm pesë ngjyra bazike , por variacionet e tyre janë aq shumë sa që nuk mund të shihen të gjitha . Janë vetëm pesë lloje mëlmesash bazike , por variacionet e tyre janë aq shumë sa që kurrë nuk mund të shijohen kurrë të gjitha ato,. Janë vetëm dy lloje përgjegjësish në betejë, sulmi befasues joortodoks dhe sulmi i drejtpërdrejtë ortodoks , por variacionet e metodave joortodokse dhe ortodokse janë të pambarim .Metoda joortodokse dhe ortodokse e ngritin njëri tjetrin , sikurse gjiroja që fillon vazhdueshëm - kush mund ti harxhojë ato ?

Kur shpejtësia e ujërave nxituese arrinë pikën kur mund të lëvizë gurët e mëdhenjë , kjo është forca e inercionit .Kur shpejtësia e daganit (zog grabitqarë) arrinë aq sa që mund të sulmoj dhe mbysë , kjo është precizitet .Pra është me luftëtarët e shkathët - forca e tyre është e lëvizshme , preciziteti i tyre është i ngushtë .Forca e tyre është sikurse hedhja me katapult e ndërsa preciziteti është si lirimi i këmbëzës së armës .

Forca e tyre është e lëvizshme në kuptimin e asaj se forca e inercionit të betejës vret kur lirohet - kjo prandaj është e ngjajshme sikurse hedhja me katapult .

Qrregullimi ngritet nga rregulli , qyqarëllëku ngritet nga guximi ,dobësia ngritet nga fuqia.

qka dm th kjo është se nëse don të shtiresh sikurse i qrregultë ashtu që ta udhëheqësh kundërshtarin në betejë , së pari duhet të jesh krejtësisht në rregull , e vetëm pastaj mund të krijoni qrregullim artificial.

Nëse dëshiron të shtiresh si qyqarë që të spiunosh gjësende nga kundërshtari, së pari duhet të jesh ekstremisht i guximshëm , e vetëm pastaj mund të veprosh si i frikësuar artificialisht .Nëse dëshiron të shtiresh si i dobët që të nxitësh mendjemadhësi tek kundërshtari , së pari duhet të jesh ekstremisht i fortë , e vetëm pastaj mund të paraqitesh si i dobët .

Rregulli dhe jorregulli janë qështje e organizimit , guximit dhe qyqarëllëku janë qështje të inercionit, fuqia dhe dobësia janë qështje të formacionit.

Kur një armatë e ka forcën e inercionit , edhe më frikacaku bëhet i guximshëm, ndërsa kur e humbet forcën e inercionit , edhe i guximshmi bëhet frikacak.Asgjë nuk është e fiksuar në ligjet e arenës së luftës - ato zhvillohen bazuar sipas momentit .

Prandaj ata që shkathtësisht i nxisin kundërshtarët të bëjnë formacionet , të cilat kundërshtari i pason me siguri, duke i dhënë çfarë kundërshtari janë të sigurtë për të ndërmarrë . Ata i lëvizin kundërshtarët me prospektin e arritjes, duke i pritur në pritë .

Formacionet të cilat kundërshtarët janë të sigurtë për ti pasuar janë formacionet të cilat japin impresionin e lodhjes.Kundërshtarët lëvizin sipas prospektit të përparësisë.

Prandaj luftëtarët e mirë kërkojnë efektivitet në betejë nga forca e inercionit , jo nga njerëzit individual. Prandaj ata janë të aftë të zgjedhin njerëzit dhe të bëjnë që forca e inercionit të bëjë punën e vet .

Kur e keni forcën e inercionit në luftë , madje edhe frikacaku mund të bëhet i guximshëm.Pra është e mundshme që të zgjidhen ata nga kapaciteti i tyre dhe tu ipet atyre përgjegjësi adekuate.Trimi mund të luftojë , i kujdesshmi mund të ruaj , inteligjenti mund të komunikojë .Asnjëri nuk është i padobishëm.

Involvimi i njerëzve që të luftojnë duke lënë që forca e inercionit të punojë është sikurse ti rrotullosh degë dhe gurë.Gurët dhe degët janë të qetë kur janë në vend të siguruar , por rrokullisen në pjerrtësi ; qëndrojnë të palëvizshëm kur janë në formë katrore , por rrotullohen kur janë të rrumbullakët . Prandaj , kur njerëzit janë shkathtësisht të udhëhequr në betejë , inercioni është sikurse ai rreth i gurëve që rrotullohet poshtë malit të lartë - kjo është forca .

6

Shpraztësia dhe Plotësia

Ata që arrjnë të parët në fushëbetejë dhe presin kundërshtarin qëndrojnë të qetë ; ata që janë të fundit në fushëetejë dhe ia mësyjnë betejës, nga aty dalin të zbathur.

Prandaj luftëtarët e mirë shkaktojnë që tjerët të vijnë tek ata, e jo të shkojnë te të tjerët.

Nëse shkaktoni që kundërshtari të vijë në luftë , atëherë forca e tyre do jetë gjithnjë e shprazët . Nëse nuk shkon që të luftosh , atëherë forca jote do jetë gjithnjë e plotë .Ky është arti i shprazjes së tjerëve dhe mbushjes tënde.

Cfarë shkakton kundërshtarin që të dalin jashtë akordit të tyre është prospekti i arritjes.Cfarë i dekurajon kundërshtarët nga arritja është prospekti i dëmit .

Pra kur kundërshtarët të jenë në qetësi , është e mundshme ti lodhni ata .Kur janë të ngopur është e mundshme që ti bëni të uritur .Kur janë duke pushuar , është e mundshme që ti lëvizni ata.

Sulmoni papritmas , duke i shkaktuar kundërshtarit që të bëhet i rraskapitur vetëm duke ikur për jetën e vet .Ua djegni furnizimet e tyre dhe shkatroni fushat e tyre , duke ia prerë rrugët e tyre furnizuese. Shfaqeni në vendet kritike dhe i sulmoni ata kur më së paku e presin , duke i bërë ata që të ikin për shpëtim.

Shfaqu ku ata nuk mund të shkojnë , dhe shko aty ku më së paku e presin ata .Udhëtimi i qindra miljeve pa lodhje , shko në vendet ku nuk ka njerëz.

Sulmimi në një shprazëtësi të hapur nuk do të thotë vetëm vendi ku kundërshtari nuk ka mbrojtje .Përderisa mbrojtja nuk është strikte , vendi nuk është i mbrojtur shtrengueshëm , ata do të humbin para teje sikur kur ti je duke udhëtuar në territorin e pabanuar.

Në mënyrë të padështuar të merrni qfarë sulmoni , sulmo aty ku nuk ka mbrojtje . Për sigurimin e një mbrojtje të padështuar, mbroju kur nuk ka sulm.

Pra në rastin e atyre që janë të shkathët në sulm, kundërshtarët e tyre nuk do të dijnë kur të mbrohen .Në rastin e atyre të shkathëtve në mbrojtje , kundërshtarët e tyre nuk do të dijnë ku të sulmojnë .

Kur direktivat zbatohen , njerëzit janë lojal të sinqertë , përgaditjet për mbrojtje janë jashtëzakonishtë të siguruta , madje jeni të padukshëm dhe besnik sa që nuk zbuloni asnjë formë të organizimit , kundërshtarët janë të pasigurtë - inteligjenca e tyre është e padobishme.

Bëhuni në mënyrë extreme të padallueshëm, madje edhe në pikën e joformës. Bëhu extremisht misterioz , madje edhe në pikën e padëgjueshmërisë .Në atë mënyrë ju mund të bëheni drejtor i fatit të kundërshtarit .

Që të avanconi pandalshmërinë , shtyni në shpraztësitë e tyre . që të braktiseni i pakapur , shpejtoni ata .

Rrethanat ushtarake bazohen në shpejtësi - vjenë si erë dhe shkon si vetëtimë, dhe kundërshtarët do të jenë të paafte që të ju mundin .

Prandaj kur dëshironi të bëni betejë , edhe nëse kundërshtari është thellë në istikame në pozicion të mbrojtjes , ai do të ta ketë të pamundur që ti shmangët luftimit nëse e sulmoni ku ai me siguri do të shkojë për shpëtim .

Kur nuk dëshironi të bëni betejë , edhe nëse e vizatoni një vijë në tokë të së cilës do i përmbaheni , kundërshtari nuk do të luftojë me ty sepse ti e ke dërguar në trase të gabuar.

Kjo e ka kuptimin se kur kundërshtari vjen të ju sulmoj juve , ju nuk luftoni me ta , por më parë vendosni ndërrim strategjik që ti vëni në konfuzion ata dhe ti bëni ata të pasigurtë.

Prandaj kur i shtytni tjetrin që të konstruktoj formacionin derisa ju vetë jeni paformë , atëherë ju jeni i koncentruar derisa kundërshtari është i ndarë .

Cfarë është mënyrë ortodokse për ty , bëj që të duket për kundërshtarin joortodokse ; cfarë është joortodokse për ty , bëj që ata ta shohin si ortodokse.Kjo është që të shtyt tjerët që të konstruktojnë formacion.Atëherë kur formacioni i kundërshtarit shihet , atëherë ju i masovizoni trupat tuaj kundër tyre .Pasi që forma juaj nuk është zbuluar , kundërshtari sigurisht do ti ndajë forcat e tij për siguri .

Derisa jeni i koncentruar në një derisa kundërshtari është i ndarë në dhjetë , ju sulmoni me koncentrimin e dhjetë në një , pra e mbivlerësoni kundërshtarin.

Nëse mund të sulmoni me disa shumë, me këtë ju do të minimizoni numrin e atyre me të cilët bëni betejë .

Derisa jeni thellësisht në istikame dhe lartë i barikaduar , duke mos lejuar asnjë informatë të dihet për ju , dil jashtë dhe mënyrë të paformë , sulmoni dhe mirrni pambarim.

Vendqëndrimi juaj në betejë nuk duhet të bëhet i ditur , sepse kur nuk mund të dihet, armiku bën shumë postblloqe me roje , dhe derisa shumë postblloqe janë bërë , atëherë ju bëni luftë vetëm me disa skuadrile të vogla .

Pra kur pjesa e parme është përgaditur , e pasmja është e mangët, kur pjesa e prapme është e përgaditur , pjesa e parme është e mangët. Përgaditja në anën e majtë nënkupton mangësi në anën e djathtë , përgaditja në të djathtë nënkupton mangësi në anën e majtë .Përgaditja gjithkund e ka kuptimin e mangësisë gjithkund.

Kjo ka kuptimin e asaj se kur trupat janë në toje në shumë vende , ata janë të shpërndarë në grupe të vogla pa vullnetin e tyre por me detyrim .

Pak janë ata në gjendje mbrojtëse kundrejt tjerëve , shumë janë ata që shkaktojnë të tjerët të jenë në gjendje mbrojtëse kundrejt vetvetës.

Sa më shumë mbrojtje që të shkaktoni që armiku juaj të adoptojë , aq më i pafuqishëm armiku juaj do të bëhet .

Pra nëse e dini vendin dhe kohën e betejës , mund ti bashkangjiteni betejës nga mijëra kilometra larg .Nëse nuk e dini kohën dhe vendin e betejës , atëherë krahu i majt i juaji nuk mund ta ruaj atë të djathtin , i djathti nuk mund ta ruaj atë të majtin , fronti nuk mund ta ruaj pasfrontin , e ndërsa pasfronti nuk mund ta ruaj frontin , madje edhe ne zonën e disa deri në disa kilometra.

Simbas vëlerësimit tim , edhe nëse keni shumë më shumë trupa se tjerët , si mund të ju ndihmojë ajo juve për fitore?

Nëse nuk e dini kohën dhe vendin e betejës , madje pavarësisht që ju jeni më shumë në numër se tjerët , si mund ta dini se a do të fitoni apo do humbni ?

Pra është thënë se fitorja mund të prodhohet .

Nëse i shkaktoni kundërshtarit që të jetë i pavetëdijshëm për vendin dhe kohën e betejës , ju gjithmonë mund të fitoni.

Edhe nëse kundërshtarët janë më shumë në numër , mund ti bësh që të mos luftojnë .

Pra vëlerësoji ata që të zbulojnë planet e veta , që të dyjat të suksesshmet dhe dështimet .Ndërseji në veprim që të zbuloni rrugën e lëvizjeve dhe pushimit të tyre.

Bërë dicka për ose kundër tyre , duke i bërë kundërshtarët që të kthejnë vëmendjen kah ti , ashtu që të zbuloni trajtat e sjelljes agresive dhe defensive të tyre .

Shkakto atyre që të adoptojnë formacione specifike , në mënyrë që të dihen bazat e vdekjes dhe jetës.

Kjo ka kuptimin e asaj se ju mund të përdorni shumë metoda që ti konfuzoni dhe pengoni armiqët që të observojnë format e reagimit të tyre ndaj teje ; pas asaj ju merreni me ta në mënyrë adekuate , ashtu që ju mund të dini çfarë lloj situatash mund të shprehet jeta , dhe në çfarë lloj situatash mund të shprehet vdekja .

Testoji ata për të zbuluar se a janë ata të mjaftueshëm dhe a janë të mangët .

Prandaj konsumimi i formimit të një armate është të arrish në joformë .Kur nuk keni formë , spiunazha undercover nuk mund të gjej asgjë , inteligjenca nuk mund të formoj strategji.

Kur nuk keni formë përceptuese , nuk leni trase për të pasuar , pra spiunët nuk mund të gjejnë ndonjë vrimë për të parë nëpërmes saj , dhe ata që janë përgjegjës për intelegjencë nuk mund të vënë ndonjë plan në operacion.

Fitorja ndaj të shumtëve , simbas kuptimit të formacionit është i panjofun për të shumtit .Të gjithë e dinë formën me të cilën unë jam fitimtarë , por askush se din formën me të cilën ta siguroj fitoren.

Prandaj fitorja në luftë nuk është e përsëritëse , por adapton formën e saj pambarim.

Përcaktimi i ndryshimeve si të përshtatshme , mos përsërit ish strategji për të arritur fitore.Cfardo formacioni që kundërshtari mund të adoptoj, nga fillimi unë mund të adaptoj për ta që të arrijnë fitore .

Formacioni ushtarak është si uji - forma e ujit është që të shmanget e larta dhe hkuarja te e ulëta , forma e forcës ushtarake është që të shmanget plotënia dhe të atakohet shpraztësia ; rrjedha e ujit është përcaktuar nga toka , fitorja e forcës ushtarake përcaktohet nga kundërshtari .

Pra forca ushtarake nuk ka formacion konstant , uji nuk ka trajtë konstante ;mundësia për të arritur fitore duke ndryshuar dhe adaptuar simbas kundërshtarit quhet gjeniale.

7

Lufta e armatosur

Rregull e rëndomtë për përdorimin e forcës ushtarake është që komanda ushtarake të pranoj urdhëra nga autoritetet civile, pastaj të mbledhë dhe masovizojë trupat , duke i vendosur së bashku në kazerma . Asgjë nuk është më e vështirë se sa lufta e armatosur.

Të luftosh me njerëzit ballë për ballë përmbi përparësitë është gjëja më e vështirë në botë.

Vështirësia e luftës së armatosur është që të bëhen distancat e largëta afër dhe kthimi i problemeve në përparësi .

Derisa jepni përshtypje se jeni shumë larg , vendosni hapin tuaj dhe shkoni atje para kundërshtarit.

Për atë ju e bëni rrugën e tyre të gjatë , duke i joshur ata në shpresa të arritjes .Kur niseni pas tjerëve dhe mbërrini para tyre , ju e dini strategjinë e bërjes së distancës më afër .

Përdorni skuadër të veqantë që të joshni kundërshtarin në ndjekjen e patës së egër , duke bërë që tui duket sikur se forca juaj kryesore është shumë larg; pastaj ju e sulmoni me një forcë sulmuese befasisht që mbërrinë e para aty , madje edhe pse është vendoset e fundit .

Prandaj lufta e armatosur konsiderohet profitabile , dhe lufta e armatosur konsiderohet e rrezikshme .

Për të shkathëtit është profitabile , për të pashkathëtit është e rrezikshme.

Të mobilizosh tërë armatën për luftë për të qenë në përparësi do të mirrte shumë kohë., megjithatë të përpiqesh për të përfitu përparësi me një ushtri të zdashur rezulton me mungesë të pajisjeve.

Pra nëse udhëton natën , duke mos ndaluar ditën ose natën , duke dyfishuar hapin e zakonshëm , përpjeka për të përfitu përparësi të njëqind miljeve larg liderët e juaj ushtarak do të kapitullojnë.Ushtarët e fortë do shkojnë atje të parët, të dobët më vonë- si rregull një nga dhjetë arrinë në cak.

Kur rruga është e gjatë ushtarët rraskapiten ; nëse fuqia e tyre është shpenzuar në procesin e udhëtimit atëherë ata janë të hendikepuar derisa kundërshtari është i freskët , pra janë të sigurtë se do të sulmohen nga kundërshtari.

Përpyekja për një përparësi 50 miljesh largësi do të pengoj planin e liderimit për bajrak në përparësi, dhe si rregull vetëm 50 % e ushtarëve ia dalin të arrijnë në cak .

Përpyekja për një përparësi 30 miljesh largësi , dhe 2 nga 3 arrijnë në cak .

Pra një armatë shkatërrohet nëse nuk ka pajisje , nëse nuk ka ushqim, dhe nëse nuk ka mjete materiale.

Këto ti gjëra janë gjithsesi të nevojshme - nuk mund të luftoni që të fitoni me një armatë të pa pajisur.

Pra nëse nuk i dini planet e kundërshtarit që ju garon , ju nuk mund të bëni aleanca të informuara.

Përveq nëse ju jeni njohës i maleve dhe kodrave , rrugëve të hapura dhe rrugëve pa dalje , shtrirjen e moqaleve dhe kënetave , nuk mund të manovroni me një forcë të armatosur . Përderisa nuk e shfrytëzoni udhëzimin lokal , nuk mund të bëni përparim në tokë.

Vetëm kur e njihni çdo detal të shtrimit të tokës mund të manovroni dhe të përballeni.

Pra forca e armatosur themelohet me mashtrim , mobilizohet me të arritur, dhe adaptohet nga divizioni dhe kombinimi.

Forca e armatosur bëhet me mashtrim, në kuptimin e asaj se ju i mashtroni armiqët , ashtu që ata nuk i dinë gjendjen tuaj reale dhe mund të bëni epërsinë. Mobilizohet me të arritur në kuptimin e asaj që shkon në aksion kur sheh përparësinë në anën e vet .Ndarja dhe rikombinimi bëhet për të qoriantu kundërshtarin dhe për të observu se si ata reagojnë ndaj teje , ashtu që ju të adaptoheni në atë mënyrë që të rrëmbeni fitore .

Prandaj kur lëvizë shpejt është sikurse era , kur lëviz ngadalë është sikurse pylli ; grabitës si zjarri , i palëkundshëm si malet .

është i shpejtë sikur era në atë se vjen pa gjurmë dhe tërhiqet si vetëtimja. është sikur pylli në kuptimin se është i rregulluar .është grabitës përmbi krejt sipërfaqen , duke mos lënë as një të vetmën lule.është i palëkundshëm sikur mal kur shërben dhe mbronë .

është vështirë ta njohësh sikurse është vështirë të dallosh në errësirë;

Lëvizjet e saj janë sikurse zhurma e murmurimës.

Që të plaqitësh lokalitetin , ndaji trupat tuaja .

Për të zgjeru territorin tëndë , ndaji të lazduarit .

Rregull për operacione ushtarake është pamundësimi i furnizimit të kundërshtarit me ushqime sa më shumë që mundesh.Megjithatë , në lokalitetet ku njerëzit nuk kanë shumë ushqime, është e nevojshme që të ndahen trupat në grupe të vogla që të marrin aty këtu tek njerëzit vetëm qka iu nevojitet , vetëm atëherë do ketë mjaftë për të gjithë .

Ndërsa sa i përket të lazduarve , kjo nënkupton që është e nevojshme që të ndahen trupat që të ruajnë atë çfarë është fituar , që tui pamundësohet marrja e atyre territoreve nga armiqët.

Vepro pasi të kesh bërë vlerësimet e duhura.

Ai i cili i pari i din masat e fitores dhe humbjes së afërt - kjo është rregull e luftës së armatosur.

I pari e bënë lëvizjen mysafiri , i fundit lëvizë nikoqiri . Mysafiri e ka vështirë , nikoqiri e ka lehtë . Larg dhe afër e ka kuptimin udhëtim- rraskapitje , uria dhe mërdhirja ngriten nga udhëtimi.

Një libër antik për rregullin ushtarak thotë " Zëri nuk dëgjohej , prandaj janë krijuar qinellat dhe tupanat . Duke pasur mungesë të qartësisë janë krijuar shenjat dhe flamujt . " Qinellat, tupanat , shenjat dhe flamujtë përdoren për të fokusuar dhe unifikuar veshët dhe sytë e njerëzve.Me të unifikuar njerëzit , i guximshmi nuk mund të vazhdojë i vetëm , frikacak nuk mund të zbrapset i vetëm - kjo është rregulla për të angazhuar grupin.

Unifikimi i veshëve dhe syve ka kuptimin e asaj që të bëjë njerëzit të shohin dhe ndëgjojnë në koncert , ashtu që ata të mos bien në konfuzion dhe të jenë të parregulltë .Shenjat përdoren për të treguar drejtimet dhe parandalimin e individëve që të nisen krye në veti .

Pra në betejat e natës , përdorni shumë zjarre dhe tupana , në betejat e kohës së ditës , përdorni shumë shenja dhe flamuj, ashtu që të manipuloni me veshët dhe sytë e njerëzve.

Përdorni shumë shenja për të befasuar perceptimet e tyre dhe bëri ata që të frikohen nga fuqia marciale e juaj e madhe .

Pra duhet të largoni energjinë nga armata e tyre, dhe largoni zemrat e gjeneralëve të tyre.

Së pari duhet të jeni i aftë për të qenë i palëkundur në vetë zemrën tuaj - vetëm atëherë mund tua merrni zemrën e gjeneralëve kundërshtarë. Kjo është qfarë thotë tradita se njerëzit e kohërave të kaluara kanë pasur zemra që tua marrin zemrat tjerëve , dhe ligji i lashtë i koqisë luftarake(një qerre e hapur me dy rrotë që tërhiqej nga një kali apo dy) thotë kur mendja themelore është e palëkundur , energjia e freskët është fitimtare .

Pra energjia e mëngjesit është madhe , e mesëditës bie poshtë , ndërsa e pasditës e ulët- prandaj ata të shkathët në përdorimin e armëve e shmangin konfrontimin me energjinë e madhe dhe sulmojnë në energjinë në rënie dhe në të ultën. Këta janë ata që zotrojnë energjinë.

Ndonjë dobësi në botë do të luftojë në minutë nëse ai eksitohet, por kur vjen tek kapja e armëve dhe kërkimi i betejës , kjo është i poseduar nga energjia - kur kjo energji tretet ata do të ndalen , do frikohen dhe do ndjehen të penduar . Arsyeja që armatat shikojnë në armikun e fortë në mënyrë se si i shikojnë femrat e virgjëra është se agresiviteti i tyre është marrë nga ta si përparësi nga armata e fortë , sepse ata janë humbur në shikim në dicka .

Përdorimi i rregullit për tu marrë me qrrregullim, duke përdorur z qetësinë për tu marrë me shamatën , është zotërimi i zemrës.

Përveq nëse zemra juaj është gjerë e hapur dhe mendja juaj është në rregull , nuk mund të pritet që të jeshë i aftë të adaptosh reagimin pa kufij , duke u marrë me qështje pagabueshëm , duke u ballafaquar me vështirësi të mëdha dhe të papritura pa u nervozuar , duke i trajtuar qetësisht cdo gjë pa konfuzion .

Qëndrimi në vendin tënd duke i pritur ata që janë larg , pritja e të lodhurve është komfort për ju , pritja e të uriturve me stomak të mbushur , është zotërimi i fuqisë.

Kjo është ajo se cfarë mendohet me nxitje tjerëve që të vijnë tek ju derisa shmangni të jeni i shtyrë që të shkoni tek tjerët .

Shmangia e konfrontimit me togjet e rregullta dhe mos sulmimi i formacioneve të mëdha është zotërimi i adaptimit.

Pra rregull i operacioneve ushtarake nuk është të ballafaqohesh

me kodër të madhe , dhe as ti kundërviheni atyre që janë të mbështetur në kodër .

Kjo d m th se kur kundërshtarët janë në një tokë të lartë ju nuk duhet të sulmoni të parët , dhe kur janë duke zbritur teposhtë nuk duhet ti ballafaqoheni me ta.

**Mos e ndjekni tërheqjen e simuluar.
Mos sulmoni trupat e fuqishëm .**

Nëse kundërshtari papritmas fillon të ikë para se të i ketë rënë energjia, me siguri që janë ngrehë kurthe në pritje për të ju sulmuar forcat , pra duhet që me kujdes të parandaloni zyrtarët tuaj nga ndjekja .

Mos e hani ushqimin e ushtarëve të tyre .

Nëse armiku papritmas i braktisë furnizimin me ushqimet e veta , ato duhen së pari të testohen para se të hahen , sepse mund të jenë të helmuara .

Mos e ndalni një armatë në rrugën e saj për në shtëpi .

Nën këto rrethana , kundërshtari do të luftojë deri në vdekje .

Armata e rrethuar duhet ti jipet një rrugë për të dal nga aty .

Tregoju rrugën për të jetu ashtu që ata nuk do jenë në disponim që të luftojnë deri në vdekje , dhe pastaj mund të bësh përparësi për ti sulmuar ata .

Mos e shtyp një armik të dëshpruar .

Një kafshë e lodhur akoma do luftojë, si qështje e ligjit të natyrës .

Këto janë rregulla të operacioneve ushtarake.

8

ADAPTIMET

Rregull e përgjithshme për operacione ushtarake është që liderët ushtarak të pranojnë urdhëra nga lidershipi civil që të mblidhen ushtritë .

**Mos lejoni që të bëhen kampimet në terrene të vështira.
Lejoni që marrëdhëniet diplomatike të themelohen në kufij.
Mos qëndroni në territor të shterpë apo të izoluar .**

**Kur jeni në vendin e rrethuar dhe atë të fshehtë .
Kur jeni në vendin e vrasjes së hapët , luftoni.**

Të qenurit në vendin e rrethuar do të thotë se aty është terreni i pjerrët në të gjitha anët , me ty ne mes të mesit , ashtu që armiku mund të vijë nga të gjitha anët dhe të shkojë lirshëm por ti ke vështirësi për të dal dhe kthyer aty .

Janë disa rrugë që nuk duhet të pasohen , ushtri që nuk duhet të sulmohen , kështjella që nuk duhet të rrethohen , territore për të cilat nuk duhet luftuar , urdhëra të qeverisë civile që nuk duhet bindur .

Prandaj gjeneralët të cilët dinë të gjitha adaptimet e mundshme për të bërë përparësi në tokë e dijnë se si të përdorin forcat ushtarake .Nëse gjeneralët nuk e dijnë se si të adaptohen me përparësi , edhe nëse e dijnë shtrirjen e tokës , ata nuk mund të bëjnë përparësi nga ajo.

Nëse i sundojnë armatat duke mos ditur artin e tërsishëm të adaptivitetit , edhe nëse e dijnë se qka mund të arrijnë atje , ata nuk mund të bëjnë që njerëzit të punojnë për ta .

Nëse mund të ndërroni me incercionin e forcës , atëherë përparësia nuk ndryshon , pra të vetmit që lëndohen janë tjerët .Prandaj nuk ka strukturë konstante .Nëse e kupton këtë princip krejtësisht, mund ti bësh njerëzit që të punojnë për ty .

Prandaj inteligjenca në shqyrtim gjithmonë i përfshin që të dyja përfitimin dhe dëmin.Pasi që e shëyrtojnë përfitimin ,

**puna e tyre mund të zgjerohet;dhe kur e shqyrtojnë dëmin ,
problemet e tyre mund të rizgjidhen .**

Përfitimi dhe dëmi janë të ndërlidhura njëra me tjetrën , kështu që mendjendrituri gjithmonë i merr parasysh ato .

**Prandaj qfarë i ndalon garuesit është dëmi,
cfarë i mbanë garuesit të zënë është puna ,
cfarë i motivon garuesit është përfitimi.**

Të rraskapitni armiqët duke i angazhuar me punë dhe duke mos i lënë të pushojnë .Por duhesh ta kesh kryer punën tënde para se të bësh këtë .Kjo punë nënkupton zhvillimin e milicisë së fortë , komb të pasur, shoqëri harmonike dhe një mënyrë të rregullt të jetës.

**Pra rregull e operacioneve ushtarake nuk është të llogaritni në
atë se kundërshtari nuk do të vijë , por të mbështeteni në pasjen
e rrugëve për tu marrë me kundërshtarin ; jo të të mbështeteni
në atë se kundërshtarët nuk do të sulmojnë , por të mbështeteni
në pasjen e asaj që nuk mund të atakohet .**

Nëse gjithmonë mund të mbani në mend rrezikun kur jeni të sigurtë dhe mbani mend kaosin në kohërat e rregullit , shiko për rrezikun dhe kaosin derisa nuk kanë marrë formë dhe parandallo ato para se të ndodhin , kjo është zgjedhja më e mirë .

**Prandaj , janë pesë veqori që në përgjithësi janë të rrezikshme.
Ata që janë të gatshëm për të vdekur mund të vriten ;
ata që kanë qëllim të jetojnë mund të zihen rob; ata që janë
të shpejtë në zemrim mund të turpërohen ; ata që janë të
dëlirë mund të zhyten ;ata që i duan njerëzit mund të
kenë probleme.**

Nëse shfaqesh në vende ku ata janë të sigurt që duhet të nxitojnë për tu mbrojtur, ata që i duan njerëzit gadi gjithmonë do të ketë ngurrim për ti shpëtuar ata , duke i shkaktuar vetes probleme dhe duke u rraskapitur në proces .

**Këto pesë gjëra janë gabime në përgjithësi ,
shkatërime për operacione ushtarake .**

Gjeneralët e mirë janë krejtësisht e kundërta ; ata nuk janë të përkushtuar për të vdekur dhe megjithatë nuk presin të jetojnë ata veprojnë në përputhje me rethanat , nuk zemrohen lehtë , nuk bëhen subjekt i turpërimit .

Kur shohin mundësinë , ata janë sikur tigrat , përndryshe ata i mbyllin dyert e tyre.Veprimi dhe mosveprimi i tyre është qështje e strategjisë dhe ata nuk mund të jenë të kënaqur apo të zemëruar .

9

Ushtritë Manovruese

Kjo ka kuptimin e zgjedhjes së rrugës më avancuese për të shkuar në të .

Kurdo që e staciononi një ushtri që të observojë kundërshtarin , shkurtoi malet dhe qëndro pranë luginave .

Shiko dritën , qëndro në lartësi . Kur luftoni në kodra , mos u ngjit (climb). Kjo aplikohet për një ushtri në male.

Një version thotë , " Lufto duke zbritur poshtë , jo duke u ngjitur lartë ".

Kur mbetesh pa ujë , gjithmonë rri larg ujit.Mos u takoni me ta në ujë ; është me përparësi që gjysmën e tyre ti lejoni ta kalojnë atë dhe pastaj ti sulmoni .Kur dëshironi që të luftoni me ta os u përball me armikuin afër ujit .

Kundroje dritën , qëndr në vende të larta , mos u përballë me rrjedhën e ujit .Kjo aplikohet për ushtrinë që është në ujë .

Nga baseni i lumit ku janë vendosur ushtritë tuaja mund të nxirren jashtë , dhe helmi mund të hdhet edhe në ujin rrjedhës .Përballja e rrjedhës së ujit ka kuptimin e marshimit në kundërrrjedhën e ujit .Gjithashtu ka kuptimin e që të mos bëni zbarkimin e barkës në ujin rrjedhës , më mirë është që armiku juaj të lundrojë në rrjedhën e ujit mu pranë jush .

Shko drejt përmes kripës në moqal , vetëm shko shpejt dhe mos u vono .Nëse shkon brenda në një ushtri në mes të një moqali kripe , qëndro tek bimët ujore , me shpinë kthyer pemëve . Kjo aplikohet tek ushtria në moqal të kripur .

Në nivelin e rrafshët , zini pozicionet ku është lehtë të manovruar , duke e mbajtur tokën e lartë në anën tuaj të djathtë , me tokë të ulët para jush dhe prapa jush të jetë tokë e lartë . Kjo aplikohet tek një ushtri në rrafshinë .

Ka qenë shfrytëzimi i përparësisë në situatën në këto katër rrugët themelore që perandori i verdhë i ka mundur katër zotëra.

Të gjitha artet marciale kanë filluar me Perandorinë e Verdhë(Sunduesi Taoist i kohës së vonë parahistorike , 2400 vite para erës sonë) pra ai përmendet këtu .

Zakonisht , një ushtri e pëlqen pozitën në tokën e lartë dhe nuk e pëlqen pozitën në tokën e ulët, e vëlerëson dirtën dhe e përbuzë errësirën.

Vendet e larta janë qliruese , ashtu që njerëzit ndihen më të qetë , dhe ato janë madje të përshtatshme për forcën e inercionit .Toka e ulët është e lagshtë , që shkakton sëmundje , dhe e bënë luftën të vështirë.

Kujdesu për shëndetin fizik dhe qëndro aty ku ka shumë burime . Kur nuk ka sëmundje në ushtri , thuhet se është e padukshme .

Kur ka kodra apo barriera qëndroni në anën e tyre që i shëndritë dielli , duke qenë ata në anën tuaj të djathtë . Kjo është pëfrparësi për forcën e armatosur , ndihmë nga toka .

Përparsi në operacione ushtarake është shfrytëzimi i ndihmës nga toka.

Kur të bie shi nga lart dhe shkuma merr rrugën poshtë në drejtimin e rrymës së lumit , nëse doni të kapërceni atë , pritni derisa të qetësohet .

Kurdo që terreni ka kodra të pakalueshme , mbyllje natyrale , burgje natyrale , kurthe natyrale , vështirësi natyrale , plasaritje natyrale , duhet të largoheni shpejt dhe mos të afroheni afër tyre .Për mua , unë qëndroj larg tyre , ashtu që kundërshtarët janë më afër tyre ; e mbaj fytyrën time në këto ashtu që kundërshtarët e kanë shpinën e kthyer nadj këtyre .

Pastaj keni përparësinë , dhe ai është pa fat .

Kur një ushtri udhëton , nëse atje ka territor malor me shumë burime uji dhe kneta apo gropa te ulta të lagështa me kallame të rritura apo vargmale të pashkelura me rritje pjellore të bimëve dhe drunjëve , është shumë e rëndësishme që ti kërkoni ato kujdesshëm dhe tejpërtej.Për këtë mundësoni grupe të veqanta për ata që ngrenë prita në kaqube të mëdha dhe për të lazduarit .

është shumë e rëndësishme që të braktisen dhe kërkohen , që të shikohet se a ka trupa që zënë pritën dhe që fshehen në vende të tilla. Gjithashtu , ekziston brengosja se spiunët mund të fshihen atje duke ju shikuar ju dhe duke i ndëgjuar direktivat tuaja.

Kur armiku është afër por i qetë ,ai akoma mbështetet në fuqinë e tij natyrale. Kur ai është larg por provon që të provokoj zemërim , ai dëshiron që ju të lëvizni përpara . Nëse pozita e tij është e kapshme , kjo gjendje është e tillë sepse ka përparësi për të .

Cka d m th kjo është se nëse kundërshtari nuk e mban pozitën e tij mbështetur në forca vetanake por e vendos vehten në një vend të përshtatshëm , duhet të jetë se atje ka përparësi praktike pasi që e bënë këtë .

Kur drunjët lëvizin , armiku është duke ardhur ; nëse ka shumë kurhta në kaqubet e vogla , është devijim .

Ideja për bërjen e shumë kurthave në kaqubet e vogla është që të ju bëjë të mendoni se dikund aty mund të jenë fshehur pritarët të fshehur prapa kaqubeve .

Nëse zogjët ngjiten lart , atje ka pritarë . Nëse kafshët frikohen , atje janë sulmuesit . Nëse pluhuri ngritet lartë dhe furishëm , makinat janë duke ardhur; nëse pluhuri është i gjerë dhe i ngadalshëm në ngritje , ushtria këmbësorie janë duke ardhur . Tym i shpërndarë në sasi të vogla na jep me kuptue për prerjen e pyllit . Sasia e vogël e pluhurit që vjen dhe shkon na jep me kuptue për vendosjen e një kampi.

Ata fjalët e të cilëve janë përrulëse derisa janë duke i shtuar përgaditjet luftarake do të bëjnë përparim .Ata fjalët e të cilëve janë të fuqishme dhe dhe që përparojnë me agresivitet do të tërhiqen.

Nëse emisartë e tyre vijnë me fjalë përrulëse , dërgo spiunë që ti observoni atë dhe do të gjeni se armiku juaj është duke i rritur përgaditjet .

Kur veturat e lehta vijnë të parat dhe qëndrojnë anash , ata do të themelnë vijën e betejës.

Ata që vijnë të kërkojnë paqe pa marrëveshje janë duke ngitur kurth .

Ata që në mënyrë të ngjeshur i largojnë rreshtat e makinave luftarake janë duke pritur përforcime.

Ata nuk do të nguten për një rikthim të zokonshëm - duhet të ketë një forcë që vjen nga larg dhe që pritet të arrijë në kohën e caktuar, me që rast do i bashkojnë forcat dhe do të vijnë të ju sulmojnë .Më së miri është që të përgaditeni për këtë menjëherë.

Nëse gjysma e forcës së tyre përparon dhe gjysma tjetër pushon , janë duke u përpjekur që të ju joshin juve.

Ata shtiren sikur janë në konfuzion dhe jorregull që të ju joshin juve në lëvizjen përpara.

Nëse mbërthehen (e shtrëngojnë rripin) deri sa janë në gjendje të qëndrimit , ata janë duke vuajtur urie. Kur ata që janë dërguar për të marrë ujë së pari pijnë vetë , ata janë të uritur .

Kur shohin një përparësi por akoma nuk e shfrytëzojnë , ata janë të rraskapitur.

Nëse zogjët mblidhen atje , vendi i tyre është boshatisur .

Nëse ka zogj në kështjellë , ushtria ka ikur.

Nëse ka thirrje gjatë natës , ata po frikohen .

Ata janë të frikësuar dhe të brengosur , kështu që e thërrasin njëri tjetrin që ta forcojnë vetvehtën.

Nëse ushtria është e pavendosur , nënkupton se gjenerali nuk po përfillet seriozisht .

Nëse shenjat lëvizin , kjo nënkupton se janë në konfuzion.

Shenjat përdoren për të bashkuar grupin , kështu që nëse lëvizin gati palëkundur , e ka kuptimin se ata me grada nuk janë në rreshta .

Nëse emisarët e tyre janë të irituar , ka kuptimin se ata janë të lodhur .

Kur ata i vrasin kuajt e tyre për mish , nënkupton se ushtarët nuk kanë ushqim ; kur nuk kanë enë për ujë me veti dhe nuk kthehen në kazemat e tyre , ata janë garues të dëshpruar .

Kur në mesin e tyre ka shushurimë, gabime në detyra , dhe biseda te tejzgjatura , lojaliteti i grupit ka humbur.

Shushurimat paraqesin bisedën e ndjenjave të vërteta , gabimet në detyra indikojnë probleme me eprorët tuaj. Kur lideri ushtarak e ka humbur lojalitetin e njerëzve , ata bisedojnë njëri me tjetrin në mënyrë të sinqertë lidhur me problemet që kanë pasur me eprorët e tyre.

Kur ata japin shpërblime të shumta , kjo nënkupton se ata janë në një qorrsoak; kur ata japin dënime të shumta , e ka kuptimin se ata janë të amortizuar .

Kur forca e inercionit të tyre është shpenzuar, ata japin shpërblime të përsëritshme që ti knaqin ushtarët e tyre , e kështu e rebelojnë massën . Kur njerëzit janë rraskapitur aq shumë sa që nuk i zbatojnë urdhërat , ata dënohen vazhdimisht që të rikthehet autoriteti .

Të qenurit i dhunshëm në fillim dhe të ndalesh pastaj duke pasur frikë nga njerëzit e tjetrit është shembull i përkryer i absurditetit.

Ata që vijnë në mënyrë pajtuese dëshirojnë që të pushojnë.

Kur forcat në mënyrë të zemruar të konfrontojnë por e vonojnë përfshirjen , e megjithatë nuk largohen , është e rëndësishme që ti shikoni ata me kujdes .

Ata janë duke përgaditur një sulm befasues.

Në qështjet ushtarake nuk është e domosdosshme e dobishme që të keni më shumë fuqi , vetëm që të shmangni paraqitjen agresive ; është e mjaftueshme që të konsolidoni fuqinë tuaj , vëlerësoni kundërshtarët , dhe të rkrutooni njerëzit , kjo është e tëra .

Individi pa strategji i cili e merr kundërshtarin të lehtë , në mënyrë ftuese do të bëhet rob i tjerëve .

Nëse nuk keni një plan të fshehtë të përtejme dhe nuk keni një paramendim të qartë , por mbështeteni vetëm në guximin tuaj individual , dhe me llafazanëri e merrni kundërshtarin lehtë duke mos i dhënë rëndësi situatës , ju sigurisht do të bëheni i burgosur.

Nëse ushtarët janë dënuar para se bashkangjitja personale ndaj liderit të jetë formuar , ata nuk do të binden , dhe nëse nuk i binden urdhërit ata është vështirë ti angazhosh .

Nëse dënimet nuk ekzekutohen pasi që bashkangjitja personale është themeluar me ushtarët , atëherë ata nuk mund të punësohen.

Kur ka ndjenja të theksuara të vlerësimit dhe besimit , dhe zemrat e ushtarëve janë të bashkuara ndaj lidershipit , nëse dënimet pushojnë ushtarët do të bëhen krenarë dhe të pamundshëm për tu angazhuar .

Prandaj drejtoji ata përgjatë arteve kulturore , bashkoji ata përmes arteve marciale , kjo padyshim nënkupton fitore.

Artet kulturore e ka kuptimin e humanitetit , artet marciale e ka kuptimin e ligjit . Komandoji ata në mënyrë humane dhe me dashamirësi , unifikoji ata strikt dhe në mënyrë serioze . Kur dashamirësia dhe serioziteti janë që të dyja evidente , është e mundshme që të jeni të sigurtë për fitore.

Kur direktivat vazhdimisht zbatohen që të përmirësojnë popullatën, popullata i pranon ato. Kur direktivat nuk zbatohen vazhdimisht për të përmirësuar popullatën , popullata nuk i pranon ato .Kur direktivat në mënyrë të vazhdueshme zbatohen, ka një kënaqje të dyanshme në mes të lidershipit dhe grupit .

10

Tereni

Disa terene janë lehtësisht të kalueshme , në disa mbetesh , disa të bëjnë që të rrih mënjane , disa janë të ngushtë , disa janë tepër të pjerrët , disa janë gjerë e gjatë të hapur .

Kur dy palët mund të vijnë dhe të shkojnë , thuhet se ai teren është lehtësisht i kalueshëm .Kur terreni është lehtësisht i kalueshëm , së pari merre pozitën tënde, duke zgjedhur anën më të lartë dhe të diellit (që dielli të mbetet prapa shpindës tënde) të përshtatshme për rrugët e furnizimit , që të keni përparësi në betejë.

Kur mund të shkoni aty por keni vështirësi në kthim prapa , thuhet se keni mbetë . Në këtë lloj terreni , nëse kundërshtari është i papërgaditur ju do të triumfoni nëse shkoni përpara, por nëse kundërshtari është i përgaditur , nëse në këto rrethana ju niseni për të përparuar dhe nuk triumfoni , do të keni vështirësi që të ktheheni prapa dhe kjo do jetë e metë për ju .

Kur për të dy palët është e pafavorshme që të përparojë , ai quhet teren mënjanes .Në terrenin mënjanes , edhe pse kundërshtari të ofron përparësi që të fillosh përparimin , nuk e shfrytëzoni atë - por tërhiqeni , duke shkaktuar që armiku të largojë gjysmën e vet jashtë këtij terreni , dhe në atë moment të pikërishtëm ju sulmoni , në përparësinë e juaj .

Në terrenin e ngushtë , nëse ke arritë i pari aty , duhet ta mbushni atë dhe të pritni për kundërshtarin . Nëse kundërshtari është i pari aty , mos shko në ndjekje nëse kundërshtari i ka mbushur të gjitha ngushticat .Ndiqi nëse nuk i ka mbushur ngushticat .

Në terrenin e pjerrët , nëse arrin i pari aty , duhet që të zësh anën e lartë dhe të diellit që të pritësh për kundërshtarin . Nëse kundërshtari është i pari aty , tërhiq nga aty dhe mos e ndjek.

Në terene gjerë e gjatë të hapura , forca e inercionit të të dyja palëve është e barabartë ,dhe është vështirë të bëni sfidë të pafavorshme për kundërshtarin që të luftoni më lehtë.

Kuptimi i këtyre gjashtë lloje të tereneve është përgjegjësia më e lartë e gjeneralit , dhe është shumë e rëndësishme që ti examini ato.

Këto janë konfigurimet e terrenit ; gjeneralët që nuk i dijnë këto humbin .

Pra në mesin forcave ushtarake ka nga ata që nguten , ata që zvarriten , ata që flijohen , ata që shkatërrohen , ata që janë kryengritës, dhe ata që marrin dajak. Këto nuk janë fatëkeqësi natyrore, por gabime të gjeneralëve .

Ata që kanë inercion të njëjtë por sulmojnë dhjetë në një janë duke u ngutur .Ata të cilët ushtarët i kanë të fortë por eprorët janë të dobët zvarriten .Ata të cilët eprorët i kanë të fortë por ushtarët i kanë të dobët flijohen .Kur kolonelët janë të zemruar dhe (obstreperous) dhe arbitrarisht luftojnë të bindur me mendjen e vetën, në vend që së pari të vlersojnë kundërshtarin kur takohen , gjeneralët nuk i njohin aftësitë e tyre, dhe ata shkatërrohen .

Në përgjithësi ,i gjithë lidershipi ushtarak duhet të jetë i një mendjeje , të gjitha forcat ushtarake duhet të bashkëpunojnë , në mënyrë që të jenë të aftë të mundin kundërshtarin .

Kur gjeneralët janë të dobët dhe me mungesë autoriteti , instruksionet nuk janë të qarta , eprorët dhe ushtarët kanë mungesë të qëndrueshmërisë , dhe formojnë vijën e frontit secili në mënyrën e vetë , kjo është kryengritje. Kur gjeneralët nuk mund të vlerësojnë kundërshtarët , përplasja me numër shumë më të madh apo me forca shumë më të fuqishme , dhe nuk zgjidhin nivelet e shkathtësive në mesin e trupave të tyre,këta janë ata që hanë dajak .

Nëse angazhoni ushtarë duke mos i ndarë të shkathtët dhe jo të shkathtë , të guximshëm dhe të frikësuar , ju jeni duke i sjellur vetëvetës dështim .

Këto janë gjashtë mënyrat për të dështuar . Kuptimi i tyre është përgjegjësia e obligueshme e gjeneralëve ; dhe ato duhet të ekzaminohen .

Së pari nuk është vlerësimi i numrave , e dyta është mungesë e sistemit të qartë të dënimeve dhe shpërblimeve , e treta është dështim në trajnim, e katërta është tejtejn gazëllimi iracional , e pesta është joefektiviteti i rendit dhe rregullit, dhe e gjashta është dështimi për të zgjedhur të fortën dhe të përkushtuarin.

Kontura e vendit është një ndihmë për një ushtri ; gjykimi i kundërshtarëve për të përcaktu fitoren , vlerësimi i rreziqeve dhe distancave , është rrugë e drejtë për veprim për liderët ushtarak. Ata që bëjnë betejë duke i ditur këto do të fitojnë , ata që bëjnë betejë duke mos i ditur këto do të humbin.

Prandaj , kur ligjet e luftës indikojnë fitore të sigurtë , sguarisht është e përshtatshme të bëni betejë , edhe nëse qeveria thotë se nuk duhet të zhvillohet betejë. Nëse ligjet e luftës nuk indikojnë fitore , është e favorshme që të mos bëni betejë , madje edhe nëse qeveria urdhëron luftë. Ata të cilët përparojnë duke mos kërkuar fitore , tërhiqen duke mos iu shmangur fajësimin personal , vetëm që të ruajnë njerëzit, e në dobi të qeverisë gjithashtu , duke i dhënë shërbim të vlefshëm kombit.

Përparimi dhe tërheqja në kundërshtim ndaj urdhërave të qeverisë nuk bëhet për interes personal , por vetëm që në mënyrë të sigurtë të ruhen jetërat e njerëzve dhe simbas dorisë së vërtetë të qeverisë .Këso lloj angazhimesh lojale i duhen kombit .

Kujdesu për ushtarët ashtu siq bënë për kalamajtë e tu , dhe ata vullnetarisht do të hyjnë thellë në luginën me juve ; kujdesuni për ushtarët tuaj sikur për fëmijët tuaj të dashur , dhe ata vullnetarisht do vdesin për ju.

Nëse jeni aq i mirë ndaj tyre sa që nuk mund ti angazhoni ata , aq i butë sa që nuk mund ti komandoni ata , aq i shkujdesur me ta sa që nuk mund të vëni rend , ata janë sikurse fëmijët e lazdruar , të padobishëm.

Shpërblimet nuk duhet të shfrytëzohen vet, dënimet nuk duhet të mbështeten në një izolim . Përndryshe , sikurse fëmijët e lazdruar , njerëzit do të bëhen komod në njërin nga këto kënaqje apo zemrim me cdo gjë. Kjo është e dëmshme dhe i bënë ata të padobishëm .

Nëse e dini se ushtarët tuaj janë të aftë për të sulmuar , por nuk e dini se a është armiku jo i dobët për ta sulmuar , ju keni gjysmë shanse për të fituar .

**Nëse e njifni armikun se është i dobët që ta sulmoni ,
por nuk e dini se ushtarët tuaj a janë të aftë që të bëjnë këtë
lloj sulmi , ju keni gjysmë shanse për të fituar .
Nëse e njihni armikun që është i dobët ndaj sulmit tuaj , dhe
e dini se ushtarët tuaj janë të aftë ta bëjnë këtë sulm, por
nuk e dini shtrirjen e tokës që e bënë të papërshtatshëm për betejë ,
ju keni gjysmë shanse për të fituar .
Prandaj ata që dijnë arte marciale nuk sorollaten kur lëvizin ,
dhe nuk shpenzohen kur kryengriten. Prandaj është thënë
se kur e njeh veten dhe të tjerët , fitorja nuk është në rrezik ;
kur e njihni qiellin dhe tokën , fitorja është e pashtershme .**

11

Nëntë bazat

Sipas rregullave për operacione ushtarake , janë nëntë lloje të bazës për operacion. Aty ku interesat e vendorëve luftojnë në mes veti dhe në territorin e vet , kjo quhet baza e shthurjes.

Kur njerëzit janë të lidhur me tokën dhe afër shtëpisë , ata ndahen shumë lehtë.

Kur hyni në vendin e tjetrit , por jo thellë , kjo quhet baza e lehtë .

Kjo e ka kuptimin se të gjithë ushtarët lehtësisht mund të tërhiqen nga ai vend që të gjithë në rast nevojë.

Toka që do të ju dhuronte përparësi juve nëse do ta mirrni dhe një të do ishte edhe ër kundërshtarin me përparësi nëse do të mirrte ai i pari quhet baza e garimit .

Baza që ju fton në garim për ta fitu është cdo barrikadë natyrore apo kalim strategjik.

Toka në të cilin ju dhe tjerët mund të arrini dhe tërhiqeni quhet baza qarkulluese .

Toka që është e rrethuar në tri anët nga garuesit , e që do i jipte përparësi të parit që ka qasje në të ndaj të gjitha grupeve tjera në garë quhet bazë ndërprerëse.

Ndërprerja e Bazës e ka kuptimin e nxënies së pritës të arterieve kryesore rrugore që i ndërlidhin së bashku disa sisteme rrugore; së pari okupoje këtë vend , dhe njerëzit do të vijnë me ju .Pra nëse e rrëmbeni do të jeni të sigurtë , nëse e humbni do jeni në rrezik të madh .

Kur hyni thellë në territorin e tjerëve , kaloni shumë qytete dhe vende , kjo quhet bazë e rëndë.

Kjo është bazë nga e cila është vështirë të riktheheni nga ajo .

Kur përshkoni male pyje të vështira për të kalu ,kodra shumë të pjerrta, lugina të lagështa apo ndonjë rrugë të vështirë për ta kalu , kjo quhet bazë e keqe .

Kur rruga në të cilën hyni është e ngushtë dhe kur dalja është në formë rrethore ashtu që një armik me numër të vogël ushtarësh mund të ju sulmojë , edhe nëse numri juaj i ushtarëve është më i madh, kjo quhet bazë e rrethuar .

Nëse keni kapabilitet të adaptimit të jashtëzakonshëm , mund të udhëtoni nëpër këtë bazë.

Kur duhet të mbijetoni nëse luftoni shpejt dhe do shkatërroheni nëse nuk e bëni atë luftë , kjo quhet baza e vdekjes.

Njerëzit në bazën e vdekjes janë , sikur të ishin ulur në një barkë që zhytet apo qëndrimi në shtëpinë që digjet .

Prandaj mos lejoni të bëhet betejë në bazën e shturur , mos lejoni ndaljen në bazën e lehtë , mos lejoni të bëhet sulm në bazën e garimit , mos lejoni që të bëhet ndërprerja në bazën qarkulluese . Në tokën e ndërprerë (me prita)krijë komunikimin, në bazën e rëndë plaqkit , në bazën e keqe vazhdoni të përparoni , në bazën e rrethuar bën plane , në bazën e vdekjes luftoni .

Në bazën e shturur , ushtarët mund të ikin.Baza e lehtë është ku ushtarët kanë hyrë të parët në territorin e armikut dhe ende nuk i kanë muret për tu mbështetur me shpindën e tyre; për këtë mendjet e ushtarëve nuk janë vërtetë të koncentruara , dhe nuk janë të gatshëm për betejë . Nuk është me përparësi që të sulmoni armikun në bazën e garimit ; ta merrni atë bazë së pari kjo po që është me përparësi.Baza qarkulluese nuk duhet të ndërpritet , ashtu që rrugët të mund të shfrytëzohen me përparësi si rrugë furnizuese.Në bazën e ndërprerë (me pritë) nëse themeloni aleancë jeni i sigurtë , nëse i humbisni aleatët jeni në shkatërrim e sipër. Në bazën e rëndë , plaqkitja nënkupton ndërtimin e furnizimeve.Në bazën e keqe , derisa nuk mund të zgjeroheni , duhet të zhvilloni shpejtësinë që të largoheni nga aty .Në bazën e rrethuar , performo në lojë taktikat e befasisë. Nëse bien në bazën e vdekjes , atëherë cdonjëri në armatë spontanisht do të luftojë.Prandaj është thënë , " Vendosni ata në bazën e vdekjes , dhe atëherë ata do të jetojnë ."

Ata që quhen ushtarak të mirë të vjetër mund të shkaktojnë që kundërshtarët e tyre të humbin kontaktin e pjesës së pasme me të parmen , humbjen e besueshmërisë në mes

grupeve të mëdha me grupet e vogla , humbjen e brensosjes së përbashkët për mirëqenien e klasave shoqërorë të ndryshme në mes tyre , humbjen e akomodimit të përbashkët në mes të sunduesve dhe të sunduarve , humbjen e rekrutimit në mesin e ushtarëve , humbjen mirëkuptimit në mes të ushtrive. Ata shkuan në aksion kur ishte me përparësi dhe u ndalën kur nuk ishte me përparësi .

Ata vendosën ndryshime për të vënë në konfuzion kundërshtarët e tyre , duke i sulmuar ata këtu aty , terrorizimin dhe qrrregullimin e tyre në atë mënyë që ata të mos kenë kohë për të planifiku.

Mund të pyeteni , kur një kundërshtar i maddh , i organizuar mirë gadi ka ardhur te ju , si të merreni me të ? Përgjigja është së pari ia largoni cfarë iu pëlqen , atëherë ata do të ju ndëgjojnë juve.

Kusht i forcës ushtarake është ajo se faktorë esencial është shpejtësia , duke e marrë përparësinë kur tjerët bëjnë gabime në ngjitje, duke shkuar nëpër rrugët në të cilat ata nuk e presin, dhe duke i sulmuar ata kur nuk kanë roje .

Kjo d m thënë se të marrësh përparësinë e papërgaditjes , mungesës së shikimit , apo mungesë të kujdesit në pjesën e kundërshtarit , është e domosdosshme që të veprohet shpejtë , kjo nuk do të punojë nëse hezitoni .

Në përgjithësi , sfondi i invazionit është ajo se invaduesit bëhen më serioz sa më shumë që hyjnë në territorin e huaj , deri në atë pikë ku sunduesi kombëtarë i vendit nuk mund ti mund ata.

Mbledh nga fushat e pasura , dhe ushtritë do të kenë mjaftueshëm për të ngrënë .Kujdesu për shëndetin tënd dhe shmangiu stresit , konsolidoje energjinë tënde dhe ndërto forcën tënde .Manovro me trupat tuaj dhe vlerëso strategjitë ashtu që të jenë të pafund.

Konsolidojeni energjinë më të madhe , ruajeni extra forcën tuaj , mbajeni formën tuaj të fshehur dhe planet tuaja sekrete , duke qenë i pafund ndaj armiqëve , duke pritur për boshllëk në dobësinë që të përparoni në të.

Vendosni ata në pikën ku nuk kanë se ku të shkojnë , dhe do të vdesin para se të ikin . Nëse duhet të vdesin aty ,

cka nuk mund të bëjnë ata ? Luftëtarët e vënë në veprim krejt fuqinë e tyre .Kur luftëtarët janë në rrezik të madh , ata nuk kanë frikë .Kur nuk kanë ndonjë vend për të shkuar ata qëndrojnë të patundur , kur janë thellësisht të involvuar në luftë ata i përmbahen asaj. Nëse nuk kanë zgjedhje, ata luftojnë.

Për këtë ushtarët janë në gjendje gadishmërie edhe pa shkak, të rekrutuar pa detyrim, shokë pa marrëveshje të shkruar, dhe të besueshëm pa komandë.

Kjo ka kuptimin e asaj se kur luftëtarët janë në rrezik vdekjeje gjithsecili i lartë apo i ulët e ka qëllimin e njëjtë , pra ata në mënyrë spontane bëhen vigjilent duke mos qenë të ngacmuar , spontanisht bëhen dashamirës dhe sillen mirë pa u detyruar, dhe janë spontanisht të besueshëm pa marrëveshje dhe komandim.

Ndalo ogurëzitë që të shmangësh dyshimet , dhe ushtarët kurrë nuk do të të lënë të vetëm .Nëse ushtarët tuaj nuk kanë të mira të veqanta , kjo nuk është për shkak se ata nuk i dojnë të mirat materiale. Nëse nuk kanë më jetë , kjo nuk është për shkak se ata nuk dëshirojnë të jetojnë gjatë . Ditën kur urdhëri për të marshuar shpallet , ushtarët qajnë.

Pra operacionet e shkathëta ushtarake duhet të jenë sikurse gjarpër i shpejtë që reagon me bisht kur dikush e sulmon atë në kokë ,dhe reagon me kokë kur dikush e sulmon në bisht , dhe reagon me të dyja kokë dhe bisht kur ndokush e sulmon në mes.

Kjo përfaqëson metodën e vijës së betejës , që reagon shpejt kur sulmohet .Manuali i tetë formacioneve klasike të betejave që thotë, " Bëre të pasmen të parme , bëre të parmen të pasme , me katër koka dhe tetë bishta .Bëje kokën kudocoftë , dhe kur armiku sulet në mes , koka dhe bishti që të dyja vijnë për ta shpëtuar mesin.

Pyetja mund të shtrohet , a mundet forca ushtarake të bëhet sikurse ky xharpër i shpejtë ? Përgjigja është po mundet . Edhe njerëzit që nuk e pëlqejnë njëri tjetrin , nëse janë në të njëjtën anije , do të ndihmojnë njëri tjetrin kur janë në vështirësi .

është forca e situatës që e bënë të ndodhë kjo .

Prandaj kuajt e lidhur dhe rrotat vorrosura nuk janë mjaftë të besueshme.

Kuajt lidhen për të bërë vendosjen e vijës së betejës, rrotat vorrosen që të bëhen makineritë të palëvizshme .Edhe pas kësaj , kjo nuk është mjaftë e sigurtë dhe të mbështetesh në to. është e nevojshme që të lejohen adaptimet ndaj ndryshimeve, vendosjen e ushtarëve në situata vdekjeprurëse ashtu që ata do të luftojnë spontanisht , duke i ndihmuar njëri tjetrit sikur dy duart - kjo është rruga për siguri dhe fitore të veçantë .

**Të nxjerrësh jashtë guximin dhe ta përshtatësh në mënyrë adekuate me situatën është metodë e Tao Organizimit.
Të jesh i suksesshëm me të dyjat me të butën dhe të fortën bazohet në shtegun e bazamentit .**

Nëse bëni përparësi në bazë , ju mund të mundni kundërshtarët edhe me trupa të dobët të butë - sa shumë , a do bënin më tepër me trupa të fortë ? Cfarë i bën të dobishëm edhe ë dobëtit edhe të fortit është konfigurimi i bazës .

Prandaj ata që janë të shkathët në operacione ushtarake arrijnë bashkupim në grup ashtu që drejtimi i grupit është si drejtimi i një individi të vetëm pa asnjë zgjidhje.

Puna e gjeneralit është mjaftë sekrete , e drejtë dhe e rregullt .

Planet e tij janë të qeta dhe thëllësisht të fshehura , ashtu që askush nuk mund ti kuptojë ato .Rexhimi i tij është i drejtë dhe i rregullt, ashtu që askush nuk guxon ta marrë atë lehtë .

Ai mund ti mbaj ushtarët të pavetëdijshëm, i bënë ata injorant.

Ai i ndrron veprimet e tij dhe i rivlerëson planet , ashtu që njerëzit nuk do i njohin ata. Ai ndrron vendbanimin e tij dhe shkon rrugëve rrethore , ashtu që njerëzit nuk mund ta parashikojnë atë .

Kur njerëzit kurrë nuk e kuptojnë se çfarë janë qëllimet tuaja , atëherë ju do fitoni .Njeriu i madh i bardhë i malit ka thënë, " Arsyja që mashtrimi vlerësohet në operacione ushtarake , nuk është vetëm për mashtrimin e armiqëve , por për të filluar me të për mashtrimin e trupave të vetë që ta përcjellin atë paditur."

Kur lideri themelon një qëllim me trupat , ai është sikurse ai që ngjitet lartë në vende të larta dhe pastaj i hudhë lehtë shkallët . Kur lideri hynë me trupat e tij thëllë në territorin e armikut , ai e nxjerrë jashtë potencialin e tyre. Ai ua ka djegur anijet dhe shkatërruar gjygmët , i udhëheqë ata sikur dele , duke mos e ditur ata se ku po shkojnë .

Të mblidhen ushtritë dhe të vendosen në situata të rrezikshme është detyrë e gjeneralëve .Adaptimet në baza të ndryshme , i jep përparësi tëkurrjes dhe zgjerimit , rrjedhja e ndjenjave humane dhe kushtet - këto duhet të ekzaminohen .

Kur ai flet lidhur me përparësitë dhe të metat e tkurrjes dhe zgjerimit , ai ka kuptimin se rrjedhja e rregullt të ndjenjave të gjitha ndryshojnë sipas llojeve të ndryshme të bazës .

Në përgjithësi mënyra se si invaduesit e bëjnë detyrën e vet është se ata bashkohen kur janë thellë në territorin e armikut por priren që të shpërndahen kur janë anash .Kur e lëni vendin tuaj dhe kaloni kufirin në operacion ushtarak, kjo është bazë e izoluar .Kur është e kapshme nga të gjitha anët, është bazë qarkulluese. Kur depërtimi është i thellë , kjo është bazë e rëndë. Kur depërtimi është i cekët , kjo është bazë e lehtë. Kur shpina juaj mbështetur në një kështjellë të pakalueshme dhe para jush janë ngushtica të pjerrëta, kjo është bazë e rrethuar.Kur nuk keni kah të shkoni , kjo është baza e vdekjes.

Pra në bazën e shthurur , do të bashkoja mendjet e trupave. Në bazën e lehtë , do ti mbaja lidhjet me ta .Në bazën e garimit , do i bëja që të më pasojnë shpejt. Në një bazë ndërprerëse , do të isha i kujdesshëm lidhur me mbrojtjen . Në bazën qarkulluese , do i bëja aleancat të palëkundura. Në bazën e rëndë , do e siguroja furnizimin e vazhdueshëm .Në bazën e keqe do i detyroja ata që të vazhdojmë rrugën përpara.Në bazën e rrethuar , do i mbyllja boshllëqet .Në bazën e vdekjes , do i jipja shenjë atyre që nuk ka mbijetesë.

Pra psikologjia e ushtarëve është që të rezistojnë kur janë të rrethuar , luftojnë kur nuk mund të shmangët lufta , dhe të binden në skajshmëri .

Jo derisa ushtarët janë të rrethuar por paraparakisht ata duhet të bëjnë që secili të ketë përkushtim për të rezistuar armikun dhe të mbajë gjallë fitoren .Kur ata janë të dëshpruar , ata e vendosin mbrojtjen e bashkuar.

Prandaj ata që nuk i dijnë planet e garuesve nuk mund të përgadisnin aleancat.Ata që nuk e dijnë shtrirjen e tokës nuk mund të manovrojnë forcat e tyre . Ata që nuk i shfrytëzojnë ciceronët vendorë nuk mund të marrin përparësinë e bazës. Ushtria e një sunduesi efektiv duhet ti dijë të gjitha këto gjëra.

Kur ushtria e një sunduesi efektiv e sulmon një vend të madh , njerëzit nuk mund të bashkohen .Kur fuqia e tyre i tejkalon kundërshtarët , aleancat nuk mund të bëhen bashkë .

Nëse jeni të aftë që të gjeni planet e kundërshtarit , merr përparësinë e bazës, dhe manovro me kundërshtarin ashtu që ata të bëhen të pavlefshëm, dhe sahtu edhe vendi i madh nuk mund të tuboj mjaft njerëz për t'u ndalur juve.

Prandaj nëse nuk garoni për aleanca ndokund , mos e strehoni autoritetin ndokund , por vetëm zgjeroni ndikimin tuaj personal , kërcënimi i kundërshtarëve , kjo e bënë vendin dhe shtetin të dobët.

Jepni shpërblime që nuk janë në rregulla , nxirrni direktiva që nuk janë në kod .

Konsideroni meritën për të dhënë shpërblim, pa rregulla të vëna paraprakisht ; Observoni kundërshtarin që të bëni premtime, pa i vendosur paraprakisht rregullat .

Angazhoni të gjitha forcat e armatosura sikurse e angazhon një person të vetëm .Angazhoi ata me detyra aktuale , dhe mos fol me ta. Motivoji ata me beneficione , mos iu trego atyre për dëmin.

Vetëm angazhoj ata që të luftojnë , mos iu trego atyre strategjinë tënde. Tregoju atyre çfarë do bëje do kenë ata për veti në të , dhe mos iu trego për dëmin potencial. Nëse e vërteta rrjedh , strategjia juaj do të priset. Nëse ushtarët brengosen, ata do jenë hesitant dhe të frikësuar.

Konfrontoji ata me faktin e shkatërrimit total , dhe ata do të mbijetojnë ; zhytni ata në situata të vdekjes , dhe ata do të jetojnë .Kur njerëzit vëhen në rrezik, atëherë ata janë të aftë të përpiqen për fitore.

Pra detyra e operacionit ushtarak është që me mashtrim të pajtoj me qëllimet e armikut. Nëse ju koncentrohni krejtësisht në armikun , ju mund të vritni lidershipin ushtarak të tyre me mijëra milje larg. Kjo është përmbushje e shkathët e detyrës.

Së pari ju shkoni përgjatë me qëllimet e tyre , e më vonë ju i vritni gjeneralët e tyre - kjo është shkathësi në përmbushjen e detyrës.

Pra në ditën kur lufta deklarohet , kufijët mbyllen , pasaportat skatërrohen , dhe emisarët nuk lejohen të kalojnë.

Qështjet trajtohen shumë strikt në komandën kryesore.

Në komandën kryesore performimi strikt në stazën e planifikimit i referohet sekretit.

Kur kundërshtarët paraqesin hapjet , duhet të depërtoni te ata menjëherë . Shkoni aty ku ata dëshirojnë së pari , dinakërisht shkatërrohi ata .Mirëmbajë disiplinën dhe adaptohu ndaj armikut në mënyrë që të përcaktoj të rezultatin e luftës. Kështu , në fillim jeni sikurse shërbëtori, kështu që armiku e hap derën e tij; pastaj jeni si lepur në ikje , dhe armiku nuk mund të ju mbaj jashtë .

12

Sulmi i zjarrët

Janë pesë lloje të sulmit të zjarrët : djegja e njerëzve, djegja e furnizimeve , djegja e pajisjeve ; djegja e magazinave dhe djegja e armëve .

Përdorimi i zjarrit duhet të ketë baza , dhe kërkon mjete të veqanta . Janë kohërat e përshtatshme për të vënë në funksion zjarret, e ato janë kur koha atmosferike është e thatë dhe me erë.

Në përgjithësi , në sulmet me zjarrë është shumë e rëndësishme që të përcillen krizat që shkaktohen nga zjarret. Kur zjarri vëhet brenda kampit të armikut , atëherë shfrytëzo rastin reago shpejt nga jashtë kampi. Nëse ushtarët janë të qetë kur zjarri ndërprehet , pritni - mos sulmoni . Kur zjarri arrinë lartësinë e fuqisë së tij , pasoje nëse mundesh, qëndro mbrapa nëse jo .

Në përgjithësi , zjarri përdoret që ti vësh armiqët në konfuzion ashtu që të mund ti sulmoni ata.

Kur zjarri mund të vëhet në vend të hapur, mos pritni deri sa të mund të vëhet brenda në kamp- vëjeni kur është koha e duhur.

Kur zjarri është vënë që era e ngritë lartë , mos sulmoni nga lartë poshtë.

Nuk është efektive që të shkoni kundrejt inercionit të zjarrit , sepse armiku sigurisht do të luftojë deri në vdekje .

Nëse era fryen gjatë ditës , era do ndaloj gjatë natës.

Koha e erës që vepron gjatë ditës do të ndalojë natën , dhe anasjelltas koha e erës gjatë natës do të ndaloj gjatë ditës .

Ushtritë duhet të dijnë se ka adaptime të pesë llojeve të sulmeve të zjarra, dhe ti qasen atyre shkencërisht .

Nuk do funksionoj kjo vetëm të dish se si të sulmosh të tjerët me sulm të zjarrët , por se është shumë e rëndësishme të dish se si të parandalosh tjerët nga sulmimi juaj .

Pra përdorimi i zjarrit për të mbështetur një sulm ka kuptimin e qartësisë, përdorimi i ujit për të mbështetur një sulm e ka kuptimin e fuqisë .Uji mund të ndërpritet , por smund të grabitet.

Uji mund të përdoret për të ndarë ushtrinë që presantohet para jush , ashtu që forca e tyre ndahet ndërsa forca juaja është e fortë .

Të fitosh në betejë apo të bësh një rrethim të suksesshëm pa i shpërblyer të merituarit është e pafat dhe e fiton epitetin e koprracisë.Prandaj është thënë se qeveria e ndritur e konsideron këtë gjë , dhe lidershipi i mirë ushtarak i shpërblen merituesit. Ata nuk mobilizohen kur nuk ka përparësi, nuk veprojnë kur nuk ka kurgjë për të fitu, nuk luftojnë kur nuk ka rrezik.

Armatimet janë instrumente të ogureve të sëmura , lufta është aferë e rrezikshme. është shumë e rëndësishme që të parandalohet debakli shkatërrimtar , pra nuk do funksionoj që të mobilizohet një ushtri për arsye të vogla - armët nuk janë vetëm për përdorim kur nuk ka zgjidhje por kur të kërkohet nevoja .

Qeveria nuk duhet të mobilizoj armatën për shkak të zemërimit , liderët ushtarak nuk duhet të provokojnë luftë për shkak të indinjatës .Vepra kur është dobiprurëse , pusho së vepruari kur nuk ka dobi. Zemërimi mund të kthehet në gëzim , indinjata mund të kthehet në kënaqësi, por kombi i shkatërruar nuk mund të rikthehet në ekzistencë , dhe të vdekurit nuk mund të rikthehen në jetë .Prandaj një qeveri e ndritur është e kujdesshme për këtë, lidershipi i mirë ushtarak është vigjilent për këtë . Kjo është mënyra për të siguru kombin dhe mbajtja e forcave të armatosura në tërësi.

13

Përdorimi i spiunëve

Operacioni i madh ushtarak shkakton shterrje të madhe të kombit , dhe mund të zgjasë me vite në luftë për një ditë të fitores. Pra dështimi për të njohur rrethanat e kundërshtarit për shkak të kundërshtimit që të jipen shpërblime për inteligjencën është në mënyrë extreme jonjerëzore, jo karakteristike e liderit të vërtetë ushtarak , jo karakteristike për liderin e vërtetë ushtarak ,për asistentin e qeverisë , për shefin fitimëtarë. Pra qka i mundëson një qeverie inteligjente dhe lideri ushtarak të menqur që të mundë tjerët dhe të arrijë përmëshje të jashtëzakonshme është dituria paraprake .

Dituria paraprake nuk mund të fitohet nga fantazmat dhe shpirtërat, nuk mund të posedohet nga analogjia , nuk mund të gjendet me kalkulime. Duhet të fitohet nga njerëzit , njerëzit që i dijnë rrethanat e armikut .

Janë pesë lloje të spiunëve :spiuni vendor, spiuni i brendshëm , spiuni rikthyes, spiuni i vdekur dhe spiuni i gjallë.Kur të gjithë llojet e spiunëve janë aktiv , askush nuk i din rrugët e tyre - kjo quhet gjeni të organizimit , dhe janë të vlefshëm për lidëshipin .

Spiunët vendor punësohen nga mesi i njerëzve të vendit . Spiunët e brendshëm punësohen nga mesi i zyrtarëve të armikut. Spiunët rikthyes angazhohen nga mesi i spiunëve të armikut .Spiunët e vdekur emetojnë intelegjencë false te armiku. Spiunët e gjallë kthehen të raportojnë .

Nga mesi i zyrtarëve të rezhimit kundërshtarë , janë ata që mund të qasen në mënyrë të fshehtë dhe tiu jipet rushfet ashtu që nëpërmjet tyre të gjinden rrethanat e vendit të tyre dhe të zbulohen planet e bëra kundër jush; ata gjithashtu mund të përdoren që të krijojnë përçarje dhe joharmoni.

Prandaj askush në forcat e armatosura trajtohet si familjarë siq janë spiunët , askujt nuk i jipet shpërblim aq pasuri ashtu siq i

jipet spiunit , dhe asnjë qështje nuk është më sekrete se sa spiunazha.

Nëse spiunët nuk trajtohen drejtë , ata mund të bëhen renegat dhe të punojnë për armikun.

Dikush mund të përdorë spiunët pa mendjemprehtësi dhe dituri, dikush nuk mund të përdorë spiunët pa njerëzi dhe drejtësi, dikush nuk mund të nxjerrë të vërtetën nga spiunët pa dinakëri. Në të vërtetë kjo është qështje shumë delikate. Spiunët janë të dobishëm gjithkund.

Cdo qështje kërkon dituri paraprake.

Nëse një njësi e inteligjencës ndëgjohe para se spiuni ta raportojë, atëherë që të dy si spiuni edhe ai që e ka thënë vdesin .

Kurdo që dëshironi të sulmoni një ushtri , rrethoni qytetin , apo vritni personin, së pari duhet të dini identitetin e gjeneralëve mbrojtës të tyre , lidhjet e tyre , vizitorët e tyre , rojtarët e portës së tyre, dhe qeverisësve të tyre , pra angazhoi spiunët ti mësojnë këto .

Kurdo që ju shkoni të sulmoni dhe të luftoni , së pari duhet të dini talentët e njerëzve të angazhuar nga kundërshtari , pra ju mund të merreni me ta sipas aftësive të tyre .

Ju duhet të kërkonte agjentët e armikut të cilët kanë ardhur që të ju spiunojnë juve , ti jepni ryshfet atyre dhe ti nxitni ata që të qëndrojnë me ju , ashtu që ti përdorni ata si spiunë rikthyes. Me inteligjencën e marrë në këtë mënyrë , mund të gjeni spiunët vendorë dhe spiunët e brendshëm që ti angazhoni për juve .Me inteligjencën e marrë në këtë mënyrë , ju mund të shkaktoni që të desinformoni spiunët e vdekur dhe ato desinformata ti servohen armikut. Me inteligjencë të marrë në këtë mënyrë , ju mund të merrni spiunët e gjallë që të punojnë si e keni planifikuar .

është esenciale për liderin që të dijë lidhur me pesë llojet e spiunazhit , dhe kjo dituri mvaret nga spiunët rikthyes , kështu që spiunët rikthyes duhet të trajtohen mirë .

Pra vetëm sunduesi briljant apo gjenerali i menqur i cili mund të përdorë inteligjentët e lartë për spiunazhë e ka siguruar

suksesin e madh .

**Kjo është esenciale për operacione ushtarake , dhe
ushtritë mvaren në këtë në veprimet e tyre .**

Nuk do të funksionoj për ushtrinë që të veprojë pa i ditur rrethanat e kundërshtarit , e ndërsa për të mësuar rrethanat reale të kundërshtarit është e pamundshme pa spiunazhë.

perktheu
driton gani nimani
14.11.2011.
fushë kosovë .

Në vend të pasthënies Urtësi nga thesari i Hasan el Basriut

Ai që i frikësohet vetëm All-llahut xh.sh., All-llahu xh.sh. bën që t'i frikësohen të gjithë të tjerët, ndërsa ai që i frikësohet botës, All-llahu bën që ai t'i frikësohet çdo gjëje.

Të kuptuarit është sikur ena në të cilën ruhet dituria. Dituria të drejton kah vepra, ndërsa vepra të dërgon në punë të mirë.

Kush e kritikon veten para njerëzve - lavdërohet; ndërsa keq është kjo që vepron.

Ruajuni lavdërimin sepse ai është vetëvrasje.

Njërin e kanë lavdëruar në praninë e Të dërguarit të All-llahut, salallahu alejhi ve selem, andaj i dërguari ka thënë: "E keni shkatërruar! Sepse, sikur ta kishte dëgjuar lavdërimin, kurrë s'do të kishte shpëtuar".

Tre dështimet më të mëdha janë:

- udhëheqësi të cilit i nënshtrohesh, e ai të mashtron,
- fqinji i cili e përhap të keqen tënde, ndërsa e fsheh të mirën tënde, dhe
- varfëria e që shkakton dhembje.

Të mos bësh mëkat është më mirë se të pendolesh.

E kam dëgjuar Ebu Bekër ibn Abdil-lah el Muzniun duke thënë: "Bëhuni këmbëngulës në punë, e nëse ju pengon pamundësia, ruajuni së paku nga mëkatet"!

Besimtari nuk dëfrehet e të bëhet i pakujdesshëm. Ai gjithnjë mendon andaj është i brengosur e i pikëlluar.

Atë që namazi i vet nuk e largon nga veprat e këqija, e largon nga All-llahu xh.sh., dhe e ndjell hidhërimin e Tij në vete.